



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 10

Tiranë – E mërkurë, 20 janar 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 5/2021, datë 18.1.2021	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 1679
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1151, datë 24.12.2020	Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, në njësitë e qeverisjes qendrore... 1679
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1152, datë 24.12.2020	Për disa shtesa në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar..... 1686
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1154, datë 24.12.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 811, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike’, Tiranë”. 1688
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1159, datë 24.12.2020	Për miratimin e garancisë shtetërore, në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kontratës së kredisë ndërmjet Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. dhe KESH sh.a. 1689
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1160, datë 30.12.2020	Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Sllovaqe për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SAIDC), për ofrimin e kontributit financiar pas tërmetit të 26 nëntorit 2019..... 1689
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1162, datë 24.12.2020	Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi..... 1692

Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 18.1.2021	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, të obligacioneve në formë regjistrimi”, të ndryshuar.....	1697
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 344, datë 31.12.2020	Për miratimin e Kodit të Etikës për Operatorin e Turizmit Detar dhe formatit të vetëdeklarimit.....	1697
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 266, datë 28.12.2020	Për miratimin e Kodit të Matjes së Gazit Natyror në Shqipëri....	1701
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 270, datë 28.12.2020	Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 94, datë 8.6.2020, “Mbi çmimin e aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2020, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020”.....	1716
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 271, datë 28.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike, të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020.....	1718
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 272, datë 28.12.2020	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.....	1719
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 273, datë 28.12.2020	Mbi miratimin e Rregullores për Burimet Dytësore të Energjisë Elektrike	1720



VENDIM
Nr. 5/2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 86/2017, “PËR
CAKTIMIN E KRYESIVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në pikën I, të vendimit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit” bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Anastas Angjeli largohet si sekretar dhe caktohet kryetar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat në vend të deputetes Milva Ekonomi.

II. Deputeti Ilir Beqaj caktohet kryetar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin në vend të deputetit Niko Peleshi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 18.1.2021

VENDIM
Nr. 1151, datë 24.12.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2021, NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 12, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e

ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2021, për njësitë e qeverisjes qendrore, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për 1 (një) inspektor në ILDKPKI nuk zbatohet pika 2, e vendimit nr. 109, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve në kryerjen e disa aktiviteteve me punonjës të përkohshëm, në njësitë e qeverisjes qendrore”.

3. Për 25 (njëzet e pesë) specialistë të ministrit të Shtetit për Rindërtim, 33 (tridhjetë e tre) specialistë të Kryeministrisë, 5 (pesë) specialistë të Sekretariatit Teknik të Komisionit të Dhënies së Dëshmisë së Statusit të Naftëtarit, 2 (dy) punonjës protokoll/arkiv, 1 (një) specialist të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe 2 dy specialistë të Drejtorisë së Pagesave dhe Dëshmipërblimeve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, 5 (pesë) specialistë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, 10 (dhjetë) specialistë në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, 2 (dy) specialistë të Ministrisë së Kulturës, 4 (katër) operatorë, 10 (dhjetë) mjekë, 20 (njëzet) infermierë dhe 15 (pesëmbëdhjetë) shoferë ambulance të Qendrës Kombëtare të Urgjencës, 700 (shtatëqind) punonjës shëndetësorë/punonjës të tjerë mbështetës të sistemit shëndetësor, të përfshirë në lidhjen nr. 1, të sipërpërmendur, nuk zbatohet pika 3, e vendimit nr. 109, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për vendosjen e standardeve në kryerjen e disa aktiviteteve me punonjës të përkohshëm, në njësitë e qeverisjes qendrore”.

4. Në mbështetje të nevojave të diktuar nga situata e pandemisë, 700 punonjësit shëndetësorë dhe punonjës të tjerë mbështetës alokohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë pranë Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe pranë stafit organik të spitaleve COVID. Për kohën e punuar në këto spitale, punonjësit e kontraktuar paguhen nga Operatori për pozicionin e punës në të cilin caktohen, ndërsa shpërblimi i punonjësve të angazhuar për diagnostikimin, trajtimin dhe shërbimin për



pacientët e prekur nga infeksioni i COVID-19, paguhet nga institucioni ku ata caktohen.

5. Pagesa për emërtesën “Punonjës arkivi (DPA)”, të përfshirë në lidhjen nr. 1, të sipërpërmendur, kryhet nga institucionet përkatëse, pas miratimit të listëprezencës dhe shënimeve përkatëse të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Ngarkohet DPA-ja të miratojë rregullat për përpunimin e fondit arkivor të mbartur dhe të njoftojë për këto rregulla punëdhënësit dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, brenda 1 (një) muaji pas miratimit të vendimit.

6. Punonjësit me kontratë në funksionin “specialist” paguhet në përputhje me kategorinë e pagës së funksionit të ngjashëm organik, të përcaktuar në strukturën e institucionit, por, në asnjë rast, kategoria e pagës së tyre në institucionet e pavarura dhe aparatet e ministrive nuk kalon nivelin IV-a dhe në institucionet në varësi të institucioneve qendrore, nivelin IV-b. Përyjashtim bëjnë specialistët e aparatit të Kryeministrisë, të cilët paguhet në kategorinë e pagës së nivelit III-b.

7. Punonjësit me kontratë në funksionin “operator EDRMS”, paguhet në përputhje me kategorinë e pagës së funksionit “operator”, në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

8. Mbulimi i efekteve financiare për punonjësit me kontratë bëhet nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të njësive të

qeverisjes qendrore. Për punonjësit me kontratë të Shtëpisë së Pushimit Durrës (MB), Shtëpisë së Pushimit të SHISH-it dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, efektet financiare përballohen nga të ardhurat e vetë institucionit.

9. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet sipas lidhjes nr. 1, të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, kategorinë përkatëse të pagës dhe burimin e financimit të tyre.

10. Ngarkohet ministri i Shtetit për Rindërtimin që, për 25 (njëzet e pesë) specialistë të përcaktuar për këtë institucion në lidhjen nr. 1, të sipërpërmendur, të bëjë detajimin e tyre në ministrinë dhe institucionet qendrore apo në institucionet e varësisë së tyre. Pagesa e këtyre punonjësve bëhet nga institucioni ku do të kontraktohet, në përputhje me pikën 6, të këtij vendimi.

11. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, fillojnë pas hyrjes në fuqi të tij. Për punonjësit, të cilët kanë lidhur kontratë në vitin paraardhës, puna e të cilëve nuk është ndërprerë dhe për të cilët është bërë regjistrimi në sistemin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, efektet financiare fillojnë më 1 janar 2021.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr.1

Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
1	Presidenca	4			
	Presidenca	3	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Presidenca	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
02	Kuvendi	12			
	Shërbimi i Botimeve Parlamentare	3	Specialist redaktimi	6 orë/ditë	Vjetore
	Shërbimi i marrëdhënieve me publikun	1	Specialist për mediat	6 orë/ditë	Vjetore
	Sektori i Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Shërbimi Financës	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Shërbimi Financës	2	Inventarizues	6 orë/ditë	8 muaj
	Drejtoria e Shërbimi Mirëmbajtjes	4	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
3	Kryeministria	85			
	Kryeministria	27	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Kryeministria	33	Specialist	8 orë/ditë	Vjetore
	Ministri i Shtetit për Rindërtim	25	Specialist	8 orë/ditë	Vjetore
05	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	248			
	Aparati i ministrisë	3	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	5	Punonjës arkivi (DPA)	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	4	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	7	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	1	Operator EDRMS	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore



Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	3	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	5	Drejtues motobarke	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	3	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës	18	Roje/mirëmbajtës	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	6	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	6	Laborant	6 orë/ditë	Vjetore
	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	4	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	2	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve	4	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve	92	Teknik i mesëm (Veteriner)	8 orë/ditë	4 muaj
	Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor	4	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor	30	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor	4	Arkivist	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Ujtjes dhe Kullimit Durrës	2	Manovratorë	8 orë/ditë	3 muaj
	Drejtoria e Ujtjes dhe Kullimit Durrës, Fier, Korçë, Lezhë	38	Punonjës mirëmbajtje zgarë	8 orë/ditë	3 muaj
	Drejtoria e Ujtjes dhe Kullimit Durrës, Fier, Korçë, Lezhë	4	Sanitare	5 orë/ditë	Vjetore
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	76			
	Aparati i ministrisë	5	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	6	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	2	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	1	Punonjës protokoli	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	5	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	20	Punonjës arkivi (DPA)	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	5	Specialist ne sekretariatit naftës	8 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i ministrisë	2	Operator EDRMS	6 orë/ditë	Vjetore
	Autoriteti Rrugor Shqiptar	4	Punonjës arkivi/protokoli	8 orë/ditë	6 muaj
	Autoriteti Rrugor Shqiptar	1	Nëpunës informacioni	8 orë/ditë	6 muaj
	Agjencia Kombëtare e Ujësllëës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme Detare	9	Specialist kapitanerie	8 orë/ditë	Maj-shtator
	Drejtoria e Përgjithshme Detare	1	Specialist për sigurinë detare	8 orë/ditë	Maj-shtator
	Drejtoria e Përgjithshme Detare	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme Detare	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Instituti i Transportit	1	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	5	Teknikë të specialiteteve të ndryshme	6 orë/ditë	Vjetore
	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	4	Roje/mirëmbajtës	6 orë/ditë	Vjetore
10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	662			
	Aparati i Ministrisë	20	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Punonjës arkiv/protokoli	8 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	15	Punonjës arkivi (DPA)	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë (Sektori i Arkiv-Protokollit)	2	Operator EDRMS	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	3	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	4	Mirëmbajtës/sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Teknik i Mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Fotokopjues	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Pagesave dhe Dëshmipërblimeve	2	Specialist	8 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Degët e Thesarit	15	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Degët e Thesarit	30	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Degët e Thesarit	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Degët e Thesarit	12	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Degët e Thesarit	1	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë	2	Specialist	6 orë/ditë	vjetore
	Agjencia e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	1	Punonjës arkiv/protokoli	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e P. Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore	328	Punonjës Shërbimi	8 orë/ditë	6-mujore
	Drejtoria e P. Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore	40	Punonjës Shërbimi	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e P. Tatimeve dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore	4	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	5	Punonjës arkiv/protokoli	6 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	1	Teknik i Mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Kombëtare e Biznesit	2	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë	1	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia e Trajimit të Koncesioneve	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	5	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	1	Lulishtar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	DPD dhe Degët Doganore	96	Punonjës shërbimi	6 orë/ditë	Vjetore
	DPD dhe Degët Doganore	7	Përpunues informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	DPD dhe Degët Doganore	14	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	DPD dhe Degët Doganore	30	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore



Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	1	Specialist	8 orë/ditë	Vjetore
	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	3	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	1	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
11	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	75			
	Aparati i Ministrisë	2	Specialiste	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	9	Operator për shërbimin <i>online</i>	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), Tiranë	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale Arsimore (Durrës, Fier, Korçë, Lezhë)	4	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Zyrat Vendore Arsimore	51	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra e Shërbimeve Arsimore	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia e Shërbimit të Sportit	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia e Shërbimit Kombëtar të Rinisë	1	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
12	Ministria e Kulturës	72			
	Aparati i Ministrisë	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Operator EDRMS	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Specialist	8 orë/ditë	Vjetore
	Galeria Kombëtare e Arteve	2	Vëzhgues/ciceron	4 orë/ditë	Vjetore
	Muzeu Historik Kombëtar	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	Muzeu Historik Kombëtar	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Muzeu Historik Kombëtar	2	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Biblioteka Kombëtare	1	Punonjës mirëmbajtje	4 orë/ditë	Vjetore
	Biblioteka Kombëtare	1	Punonjës protokoll/arkivi	4 orë/ditë	Vjetore
	Biblioteka Kombëtare	1	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Zyra e Parkut Arkeologjik Butrint	5	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Mars-tetor
	Zyra e parkut Arkeologjik Butrint	3	Vëzhgues/ciceron	6 orë/ditë	6 muaj
	Zyra e parkut Arkeologjik Butrint	1	Vëzhgues/ciceron	6 orë/ditë	Vjetore
	Zyra e parkut Arkeologjik Butrint	1	Biletashitës	6 orë/ditë	Vjetore
	Zyra e Parkut Arkeologjik Butrint	2	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Zyra e parkut Arkeologjik Butrint	2	Sanitar	8 orë/ditë	6 muaj
	Zyra e parkut Arkeologjik Butrint	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	ZAK Parku Arkeologjik Apoloni, Bylis	2	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	Mars-tetor
	ZAK Parku Arkeologjik Apoloni, Bylis	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	ZAK Parku Arkeologjik Apoloni, Bylis	1	Biletashitës	6 orë/ditë	8 muaj
	Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar	1	Biletashitës	6 orë/ditë	Maj-tetor
	Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore	2	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore	2	Arkivist	4 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e Kulturës kombëtare Gjirokastrë	2	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Prill-nëntor
	Drejtoria Rajonale e Kulturës kombëtare Gjirokastrë	1	Sanitar	6 orë/ditë	Prill-nëntor
	Drejtoria Rajonale e Kulturës kombëtare Gjirokastrë	1	Biletashitës	6 orë/ditë	Prill-nëntor
	Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi"	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër	1	Sanitar	4 orë/ditë	Shkurt-Dhjetor
	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër	1	Punonjës mirëmbajtje	8 orë/ditë	Prill-Shtator
	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë	2	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Berat	2	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Maj-shtator
	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Berat	1	Ciceron	6 orë/ditë	Mars-nëntor
	Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"	2	Vëzhgues (ciceron/guida)	6 orë/ditë	Vjetore
	Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"	1	Biletashitës	6 orë/ditë	Vjetore
	AQSHF	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	AQSHF	1	Restaurator	6 orë/ditë	Vjetore
	Cirku Kombëtar	1	Sanitar	6 orë/ditë	6 Muaj
	Qendra e Muzeore Berat	1	Vëzhgues	6 orë/ditë	Maj-tetor
	Qendra e Muzeore Berat	1	Sanitar	4 orë/ditë	Maj-tetor
	Qendra e Muzeore Durrës	2	Punonjës Mirëmbajtje	5 orë/ditë	Prill-gusht
	Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	1	Arkivist	4 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë	2	Punonjës Mirëmbajtje	6 orë/ditë	Mars-tetor
	Qendra Kombëtare e Veprimave Folklorike	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë	1	Punonjës Mirëmbajtje	8 orë/ditë	Maj-tetor
	Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit	2	Specialist	4 orë/ditë	Mars-tetor
	Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit	1	Sanitar	4 orë/ditë	Mars-tetor
	Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit	1	Biletashitës	4 orë/ditë	Mars-tetor
13	Ministria Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	844			
	Aparati i Ministrisë	6	Operator	6 orë/ditë	Vjetore



Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
	Aparati i Ministrisë	1	Operator EDRMS	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	3	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	4	Operator	8 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	10	Mjekë	8 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	20	Infermierë	8 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	15	Shoferë ambulance	8 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoritë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor	700	Punonjës shëndetësorë/punonjës të tjerë	8 orë/ditë	Vjetore
	Spitali Psikiatrik Elbasan	3	Kaldajst	6 orë/ditë	Janar – mars nëntor – dhjetor
	Qendra Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët	2	Mjek	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Kombëtare Mirërritjes, Zhvillimit Fëmijëve	1	Psikolog	4 orë/ditë	Vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	Vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	1	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	5	Kujdestar	4 orë/ditë	Vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Tiranë	1	Ndihmëskuzhinier	4 orë/ditë	Vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	1	Mjek i përgjithshëm	4 orë/ditë	Vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	1	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër	1	Ndihmëskuzhinier	4 orë/ditë	Vjetore
	Shtëpia e Fëmijëve Shkollor Tiranë	2	Kujdestar	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra e Zhvillimit Tiranë	1	Mjek	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra e Zhvillimit Tiranë	1	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra e Zhvillimit Tiranë	1	Ndihmëskuzhinier	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra e Zhvillimit Durrës	1	Mjek	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra e Zhvillimit Durrës	2	Kujdestar	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra e Zhvillimit Durrës	1	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Trajimit të Viktimave të Dhunës në Familje,	1	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Trajimit të Viktimave të Dhunës në Familje,	1	Psikolog	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Trajimit të Viktimave të Dhunës në Familje,	2	Kujdestar	4 orë/ditë	Vjetore
	Qendra Trajimit të Viktimave të Dhunës në Familje,	1	Punonjës social	4 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e SHSSH Tiranë	1	Operator	6 orë/ditë	6 muaj
	Drejtoria Rajonale e SHSSH Tiranë	5	Mjek	8 orë/ditë	6 muaj
	Drejtoria Rajonale e SHSSH Tiranë	5	Punonjës social	8 orë/ditë	6 muaj
	Drejtoria Rajonale e SHSSH Tiranë	5	Specialist	8 orë/ditë	6 muaj
	Drejtoria Rajonale e SHSSH Durrës	3	Mjek	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e SHSSH Durrës	3	Punonjës social	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e SHSSH Durrës	3	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e SHSSH Elbasan	6	Mjek	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e SHSSH Elbasan	6	Punonjës social	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria Rajonale e SHSSH Elbasan	6	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH	9	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e SHSSH	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
14	Ministria e Drejtësisë	29			
	Aparati i Ministrisë	8	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor	2	Arkivist	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	1	Sanitare	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	1	Punonjës Arkiv/Protokolli	6 orë/ditë	Vjetore
	Instituti i Mjekësisë Ligjore	2	Laborantë/ndihmësprojektor	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Zyra Përbarimore Tiranë	1	Ftues	6 orë/ditë	Vjetore
	Zyra Përbarimore Tiranë	1	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Komiteti Shqiptar i Birësimeve	1	Punonjës arkiv/protokolli	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	1	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
15	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	23			
	Aparati i Ministrisë	5	Preparatorë	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Punonjës arkiv/protokolli	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Postier	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Centralist	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	4	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	4	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Operator EDRMS	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë Task-Forca e MEP]	1	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
16	Ministria e Brendshme	66			
	Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit	1	Sanitar	8 orë/ditë	6 muaj



Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periodhë kohore
	Shtëpia e Pushimit Durrës	3	Kuzhinier	8 orë/ditë	1.6.2021–10.9.2021
	Shtëpia e Pushimit Durrës	2	Ndihmëskuzhinier	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e Pushimit Durrës	10	Kamerier	8 orë/ditë	1.6.2021–10.9.2021
	Shtëpia e Pushimit Durrës	5	Punëtor restoranti	8 orë/ditë	1.6.2021–10.9.2021
	Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Teknik	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e Pushimit Durrës	3	Receptionist	8 orë/ditë	1.6.2021–10.9.2021
	Shtëpia e Pushimit Durrës	10	Punëtor gjelbërimi	8 orë/ditë	1.6.2021–10.9.2021
	Shtëpia e Pushimit Durrës	5	Punëtor kuzhine	8 orë/ditë	1.6.2021–10.9.2021
	Shtëpia e Pushimit Durrës	12	Punëtor hoteli	8 orë/ditë	1.6.2021–10.9.2021
	Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Elektrici	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e Pushimit Durrës	1	Teknik i Mesëm	8 orë/ditë	6 muaj
	Shtëpia e Pushimit Durrës	2	Lavanteri	8 orë/ditë	1.6.2021–10.9.2021
	Shtëpia e Pushimit Durrës	2	Punëtor/vrojues plazhi	8 orë/ditë	1.6.2021–10.9.2021
	Agjencia e Programeve të Veçanta të Shtetësisë	1	Sanitar	8 orë/ditë	1.3.2021–31.8.2021
	Agjencia e Programeve të Veçanta të Shtetësisë	1	Arkivist	8 orë/ditë	1.3.2021–31.8.2021
	Agjencia e Programeve të Veçanta të Shtetësisë	1	Punonjës mirëmbajtje	8 orë/ditë	1.3.2021–31.8.2021
	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	1	Specialist	8 orë/ditë	1.2.2021–30.4.2021
	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	2	Teknik i Mesëm	8 orë/ditë	1.2.2021–30.4.2021
	Prefekti i Qarkut Tiranë	2	Arkivist	6 orë/ditë	Vjetore
17	Ministria e Mbrojtjes	1			
	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	26			
	SHISH (shtëpitë e pushimit)	6	Kuzhinier	8 orë/ditë	3 muaj
	SHISH (shtëpitë e pushimit)	2	Banaker	8 orë/ditë	3 muaj
	SHISH (shtëpitë e pushimit)	12	Sanitar	8 orë/ditë	3 muaj
	SHISH	6	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	15			
	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	15	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
22	Akademia e Shkencave	1			
	Akademia e Shkencave	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	55			
	Aparati i Ministrisë	2	Operator EDRMS	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	2	Punonjës arkiv/protokolli	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	1	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati i Ministrisë	5	Specialist	8 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	Punonjës Mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Turizmit	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	1	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	1	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	10	Specialist	8 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	1	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	4	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	12	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	8	Operatorë	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	1	Sanitare	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	1	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
28	Prokuroria e Përgjithshme	28			
	Prokuroria e Përgjithshme	2	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Prokuroria e Përgjithshme	4	Punonjës arkivi (DPA)	6 orë/ditë	Vjetore
	Prokuroria e Përgjithshme	1	Lulishtar	4 orë/ditë	Vjetore
	Prokuroritë e Rretheve dhe Apeleve	16	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Prokuroria Rrethit Tiranë dhe Vlorë	2	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Prokuroritë e Rretheve dhe Apeleve	3	Punonjës shërbimi	6 orë/ditë	Vjetore
29	Këshilli i Lartë Gjyqësor	27			
	Këshilli i Lartë Gjyqësor	3	Sekretar gjyqësor	6 orë/ditë	6 muaj
	Këshilli i Lartë Gjyqësor	10	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Këshilli i Lartë Gjyqësor	2	Punonjës arkiv/protokolli	6 orë/ditë	Vjetore
	Këshilli i Lartë Gjyqësor	2	Punonjës arkivi (DPA)	6 orë/ditë	Vjetore
	Këshilli i Lartë Gjyqësor	10	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
30	Gjykata Kushtetuese	2			
	Gjykata Kushtetuese	2	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	10			
	Agjencia Telegrafike Shqiptare	9	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Telegrafike Shqiptare	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
35	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	6			
	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	3	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Këshilli i Lartë i Prokurorisë	2	Teknik mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
41	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	6			
	Administrata e Strukturës	3	Specialist arkiv/protokolli	6 orë/ditë	Vjetore



Gr.	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
	Administrata e Strukturës	2	Sanitare	6 orë/ditë	Vjetore
	Administrata e Strukturës	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	1			
	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
63	Komisioneri Publik	2			
	Komisioneri Publik	1	Sanitar	3 orë/ditë	Vjetore
	Komisioneri Publik	1	Teknik i mesëm	3 orë/ditë	Vjetore
63	Kolegji i Posaçëm i Apelit	6			
	Kolegji i Posaçëm i Apelit	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Kolegji i Posaçëm i Apelit	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Kolegji i Posaçëm i Apelit	1	Specialist arkiv/protokoll	6 orë/ditë	Vjetore
	Kolegji i Posaçëm i Apelit	3	Sekretar gjyqësore	6 orë/ditë	Vjetore
63	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	6			
	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	3	Sekretar gjyqësore	6 orë/ditë	Vjetore
	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	1	Specialist Redaktor	6 orë/ditë	Vjetore
	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	1	Arkivist	6 orë/ditë	Vjetore
63	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	8			
	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	2	Specialist arkiv/protokoll	6 orë/ditë	Vjetore
	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	2	Specialist shërbimesh	6 orë/ditë	Vjetore
	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	1	Redaktor	6 orë/ditë	Vjetore
	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë	3	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Mars – dhjetor
66	Avokati i Popullit	7			
	Avokati i Popullit	7	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
67	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil	4			
	Komisioneri	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Komisioneri	2	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Komisioneri	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
76	Inspektorati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	1			
	Aparati i ILDKPKI	1	Inspektor	8 orë/ditë	Vjetore
77	Autoriteti i Konkurrencës	3			
	Autoriteti i Konkurrencës	2	Punonjës Arkiv/Protokolli	6 orë/ditë	Vjetore
	Autoriteti i Konkurrencës	1	Teknik i Mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
87	Institucione të tjera qeveritare	48			
	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia e Prokurimit Publik	3	Punonjës arkivi (DPA)	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia e Prokurimit Publik	3	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Departamenti Administratës Publike	1	Nëpunës informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Departamenti Administratës Publike	1	Punonjës mirëmbajtje	6 orë/ditë	Vjetore
	Departamenti Administratës Publike	3	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Për Dialog dhe Bashkëqeverisje	1	Teknik/korrier	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Për Dialog dhe Bashkëqeverisje	3	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	20	Specialist	8 orë/ditë	6 Muaj
	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore)	4	Sanitar	4 orë/ditë	Vjetore
	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	2	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Avokatura e Shtetit	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Avokatura e Shtetit	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	Avokatura e Shtetit	1	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Vjetore
	Avokatura e Shtetit	1	Punonjës arkiv/protokolli	6 orë/ditë	Vjetore
	Avokatura e Shtetit	1	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
88	Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile	2			
	Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile	1	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	5			
	Komisioneri	1	Sanitar	6 orë/ditë	Vjetore
	Komisioneri	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	Komisioneri	2	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Komisioneri	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
90	Komisioni i Prokurimit Publik	2			
	Komisioni i Prokurimit Publik	1	Punonjës protokoll	6 orë/ditë	Vjetore
	Komisioni i Prokurimit Publik	1	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
95	Autoriteti Informimit Dok. Ish-Sigurimit të Shtetit	4			
	Aparati institucionit	2	Operator	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati institucionit	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	Vjetore
	Aparati institucionit	1	Teknik i mesëm	6 orë/ditë	Vjetore
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	2,472			



VENDIM

Nr. 1152, datë 24.12.2020

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

a) në pikën 1/3/b shtohet emërtesa “Agiencia e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë”;

b) në pikën 4/19, pas emërtesës “Përgjegjës sektori” shtohet emërtesa “Menaxher cilësie”;

c) pas pikës 9/16 shtohet pika 9/17, me këtë përmbajtje:

“9/17 Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor, janë sipas lidhjes nr. 6/17, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”;

ç) në rreshtin e tretë të lidhjes nr. 7, që përmendet në pikën 10, pas emërtesës “Drejtor drejtorie”, shtohet emërtesa “Menaxher cilësie në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit”;

d) pas pikës 10/5 shtohet pika 10/6, me këtë përmbajtje:

“10/6. Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” dhe “Drejtor i Përgjithshëm”, në Agjencinë e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë, janë sipas lidhjes nr. 7/6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”;

dh) pas pikës 12/6 shtohet pika 12/7, me këtë përmbajtje:

“12/7 Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i degës”, në degët rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, janë sipas lidhjes nr. 9/7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e secilit institucion dhe të fillojnë:

a) nga data 1 janar 2021, për Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor dhe degët rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor;

b) nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë për parashikimet e tjera të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



Lidhja nr. 6/17

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve, për emërtesat “specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
Titullar i institucionit	II-a	1	18.500
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	III-a/1	1	18.500
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	III-a/1	1	0
	III-b	1	0
Inspektor	III-b	1 ose 2	18.500
Specialist në sektorët dhe drejtoritë e përmbajtjes	IV-a	1 ose 2 ose 3	18.500
Specialist në sektorët mbështetës	IV-a	1 ose 2 ose 3	0
	IV-b	1 ose 2 ose 3	0

Lidhja nr. 7/6

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve, për emërtesat “Specialist” dhe “Drejtor i Përgjithshëm”, në Agjencinë e Hartimit të Programeve të Veçanta të Shtetësisë

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Drejtor i Përgjithshëm	II-b	1
Specialist	III-b	1 ose 2

Lidhja nr. 9/7

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve, për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar i degës”, në degët rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
Titullar i institucionit rajonal	III-b	1	18.500
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes	IV-a	1	18.500
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës	IV-a	1	0
Inspektor	IV-b	1 ose 2 ose 3	18.500
Specialist në sektorët mbështetës	IV-b	1 ose 2 ose 3	0



VENDIM
Nr. 1154, datë 24.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 811, DATË 26.12.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘PËR NDËRTIMIN E LANDFILLIT, INCENERATORIT DHE REHABILITIMIN E VENDDEPOZITIMEVE EKZISTUESE TIRANË DHE PRODHIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE’, TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 811, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë arë” dhe “vresht”, me vlerë të përgjithshme 325 770 560 (treqind e njëzet e pesë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë.”;

b) pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1 Vlera shtesë prej 40 774 720 (dyzet milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzet) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.”;

c) pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5.1 Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.”;

ç) tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 811, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, i shtohet tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, si dhe shoqëria koncesionare “Integrated Energy BV SPV” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

Lista e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit “Për disa ndryshime në vendimin nr. 811, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, ‘Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit: ‘Për ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozitimeve ekzistuese, Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike’, Tiranë”

Nr.	Nr. sipas shkresës së hipotekës	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Sip. e shpronësuar m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale në lekë	Shënime
1		Bashkëpronarët XHEPA etj.	Vresht	3321	301/17	3600	3600	448	1612800.00	Kartelë pasurie datë 17.2.2020.
2	13	Zenepe Hoxha	Vresht	3321	185/2	5200	5200	448	2329600.00	Kartelë pasurie datë 17.2.2020.
3	25	Jakup Lamuça	Arë	3321	295/4	1000	100	448	44800.00	Kartelë pasurie datë 17.2.2020.
4	19	Kasem Lamuça	Arë	3321	298/22	500	100	448	44800.00	Kartelë pasurie datë 17.2.2020.
SIP. TOTALE								9000	4032000.00	

Lista e pasurive pa informacion

1	1	Pa informacion	Arë	3321	172	98560	77820	448	34863360.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja me shkresën nr. prot. 239931, dt. 20.11.2017, dhe nr. prot. 13562, dt. 7.2.2018.
2	49 dhe 50	Pa informacion	Arë	3321	331/4	805	805	448	360640.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja me



										shkresën nr. prot. 239931, dt. 20.11.2017, dhe nr. prot. 13562, dt. 7.2.2018.
3	50 dhe 49	Pa informacion	Arë	3321	331/5	1125	1125	448	504000.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja me shkresën nr. prot. 239931, dt. 20.11.2017, dhe nr. prot. 13562, dt. 7.2.2018.
4		Pa informacion	Arë	3321	317/1	615	615	448	275520.00	Në sistemin e ZRPP-së.
5		Pa informacion	Arë	3321	332/19	1650	1650	448	739200.00	Në sistemin e ZRPP-së.
Vlera e pasurive pa informacion									36742720.00	

VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT TË PASURIVE ME EMRA PRONARËSH DHE E PASURIVE PA INFORMACION

40774720.00

Vlerësimi i pasurive të llojit "tokë arë" dhe "vresht", është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.

VENDIM

Nr. 1159, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E GARANCISË SHTETËRORE, NË FAVOR TË INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, NË KUADËR TË KONTRATËS SË KREDISË, NDËRMJET INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA DHE KESH SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 dhe 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e garancisë shtetërore, në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kontratës së kredisë, ndërmjet Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. dhe KESH sh.a., për shumën 10 295 906.00 (dhjetë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtë) euro.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM

Nr. 1160, datë 30.12.2020

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE AGJENCISË SLOVAKE PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (SAIDC), PËR OFRIMIN E KONTRIBUTIT FINANCIAR PAS TËRMETIT TË 26 NËNTORIT 2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Slovake për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SAIDC), për ofrimin e kontributit financiar pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR OFRIMIN E KONTRIBUTIT
FINANCIAR NR. SAMRS/2020/02/AL
LIDHUR AKTIT SLOVAK NR. 392/2015
KOL. (18 NËNTOR 2015) MBI
BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM DHE
NDRYSHIMIN E AKTEVE TË CAKTUARA**

Palët e Marrëveshjes

Ofruesi:

Agjencia Sllovaqe për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SAIDC) (në gjuhën sllovaqe Slovenská agentúra pre medzinárodnú rozvojovú spoluprácu)

Pražská 7, 811 04 Bratislava, Slovakia

Numri i regjistrimit: 31819559

Përfaqësuar nga: Lucia Kišš, Drejtore

Të dhëna bankare: Štátna pokladnica, SK13
8180 0000 0070 0027 5962

(në vijim i referuar si “SAIDC”)

Përfituesi:

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Përfaqësuar nga: Ministri i Shtetit për Rindërtim
(në emër të Këshillit të Ministrave)

në vijim të referuara si “Palët”,

Kanë rënë dakord për çështjet në vijim:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Objekti i kësaj Marrëveshjeje është kontributi financiar i dhënë nga SAIDC si organizatë buxhetore e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës Sllovaqe tek Përfituesit përfundimtarë të aktiviteteve, njësitë bashkiake të Përfituesit, duke qenë Bashkia Lezhë, në shumën 67 000 euro (gjashtëdhjetë e shtatë mijë euro) dhe Bashkia e Tiranës në shumën 183 000 euro (njëqind e tetëdhjetë e tre mijë euro), për aktivitetet e përshkruara në seksionin 2 të këtij neni për projektin “Rindërtimi i shkollave të dëmtuara dhe rehabilitimi nga tërmeti i nëntorit 2019” (në vijim i referuar si “Projekti”). Ky kontribut financiar do të ofrohet me miratimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës Sllovaqe, nga data 4 maj 2020.

2. Kontributi financiar do të përdoret për aktivitete të lidhura me:

a) Rindërtimin e shkollës fillore në Pezë-Helmes në Tiranë, në shumën prej 165 000 eurosh.

b) Rindërtimin e shkollës fillore në Kallmet, Lezhë në shumën prej 46 000 eurosh.

c) Rindërtimin e shkollës fillore në Manat, Lezhë në shumën prej 21 000 eurosh.

d) Kontributin financiar ndaj Fondit të Posaçëm të Bashkisë së Tiranës, për qëllime të rindërtimit pas dëmtimeve nga tërmeti në shumën prej 18 000 eurosh;

3. Kontributi financiar do të administrohet nga përfituesit përfundimtarë dhe do të përdoret nga përfituesit përfundimtarë për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve për Projektin, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje. Përfituesit përfundimtarë do të bëjnë çdo përpjekje për të garantuar përdorimin efektiv të kontributit të dhënë nga kjo Marrëveshje. Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, Bashkia e Tiranës dhe Bashkia Lezhë do të veprojnë si Njësi Zbatuese për Përfituesin. Projekti do të zbatohet deri më 31 dhjetor 2021.

Neni 2

Kuadri ligjor dhe objekti i Projektit

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi dhe ofrimi i kontributit financiar bazohen në Aktin Sllovak nr. 392/2015 kol. (e 18 nëntorit 2015) për Bashkëpunimin për Zhvillim dhe për ndryshimin e akteve të caktuara dhe ligjeve të tjera përkatëse sllovaqe.

2. Zbatimi i Projektit dhe përdorimi i kontributit financiar nga përfituesit përfundimtarë rregullohen gjithashtu nga ligji nr. 97/2019, në lidhje me miratimin e aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Akti për ndihmën e dëmtimeve nga fatkeqësitë natyrore” dhe vendimi nr. 30, datë 19.6.2020, i Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

3. Brenda fushëveprimit të Projektit, një total prej 3 (tre) objektsh arsimore do të rindërtohen në zonat e prekura nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, në Shqipëri.

Neni 3

Detyrimet e Palëve

1. Ky kontribut financiar mbulon dhe mund të përdoret vetëm për ofrimin e mallrave dhe



shërbimeve të pranueshme në lidhje me “Projektin”.

2. Kontributi financiar nga SAIDC te përfituesit përfundimtarë (i përcaktuar në nenin 1) u dërgua pas miratimit të kontributit financiar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës Sllovaqe, kontributi mund të përdoret nga përfituesit përfundimtarë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Përfituesi do të rregullojë që përfituesit përfundimtarë do të jenë të detyruar të përdorin logon zyrtare SlovakAid, në të gjitha dokumentet dhe korrespondencën, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe aktivitetet e mbështetura.

4. Përfituesi do të marrë masa që përfituesit përfundimtarë do të jenë të detyruar të informojnë SAIDC-në, për të gjitha rrethanat që mund të shkaktojnë një devijim të konsiderueshëm dhe/ose të rrezikojnë objektivat e kësaj Marrëveshjeje dhe performancën e Projektit.

5. Përfituesi do të marrë masa që përfituesit përfundimtarë do të jenë të detyruar të informojnë SAIDC-në me shkrim, në lidhje me përdorimin e kontributit financiar dhe të dërgojnë një dokument fotografik model ose prova të tjera të përshtatshme të përdorimit të kontributit siç specifikohet në këtë Marrëveshje nga data 31 dhjetor 2020. Me kërkesë të SAIDC-së, ata do të sigurojnë dokumentacion dhe prova shtesë.

6. Përfituesi do të marrë masa që përfituesit përfundimtarë të lejojnë SAIDC-në, palët e treta të autorizuar nga SAIDC-ja dhe autoritetet kontrolluese të Republikës Sllovaqe ose autoritetet e autorizuar të shteteve të tjera për të kontrolluar qëllimin dhe kushtet e përdorimit, raportimin dhe rezervimin e kontributit, siç specifikohet në këtë Marrëveshje ose ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, veçanërisht në aktin sllovak nr. 357/2015, mbi kontrollin financiar dhe auditimin, e ndryshuar. Ky detyrim mbetet i vlefshëm edhe pas periudhës së rënë dakord të kësaj Marrëveshjeje.

7. Nëse përfituesit përfundimtarë të përdorimit të kontributit financiar në kundërshtim me përshkrimin e specifikuar në këtë Marrëveshje ose nuk mund të provojnë përdorimin e duhur, SAIDC mund të vendosë të përfundojë Marrëveshjen dhe të kërkojë rimbursimin e plotë ose të pjesshëm të kontributit financiar të alokuar nga Përfituesi.

8. Përfituesi do të marrë masa që përfituesit përfundimtarë do të rimbursojnë kontributin financiar të alokuar ose një pjesë të tij brenda 15 ditësh pune nga data e dorëzimit efektiv të kërkesës së SAIDC-së te ta në formë të shkruar. Kontributi financiar i alokuar ose një pjesë e tij duhet të rimbursohen në llogarinë e SAIDC-së.

9. Nëse përfituesit përfundimtarë nuk e rimbursojnë kontributin financiar të alokuar ose një pjesë të tij brenda periudhës kohore të lartpërmendur, SAIDC mund t'i ngarkojë Përfituesit tarifës së pagesës së vonuar, në shumën prej 0,05% të shumës së plotë të kontributit të përmendur në seksionin I të kësaj Marrëveshjeje për çdo ditë vonese ose një pjesë të saj. Penaliteti është i kërkueshëm dhe i pagueshëm brenda 5 ditësh pune pas dorëzimit efektiv të kërkesës për pagesën e saj te Përfituesi, në llogarinë e SAIDC-së.

Neni 4

Vlefshmëria e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të së cilës palët do të njoftojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të tyre ligjore për hyrjen e saj në fuqi. Palët konfirmojnë se për shkak të nevojës urgjente për të ofruar ndihmë humanitare pas tërmetit të muajit nëntor 2019, fondet e kontributit financiar tashmë i janë dhënë Përfituesit nga SAIDC-ja përpara se të lidhin këtë marrëveshje me shkrim të bashkëpunimit, bazuar në një marrëveshje verbale për ofrimin e kontributit financiar me të njëjtën përmbajtje dhe bazuar në angazhimet e Sllovakisë në konferencën ndërkombëtare të donatorëve së Bashku për Shqipërinë.

2. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi nuk do të ndikojë në aktivitetet dhe projektet tashmë në progres ose të ekzekutuar.

3. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet në çdo kohë, me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të palëve. Ndryshimet më pas do të hyjnë në fuqi sipas procedurës së përshkruar në paragrafin 1 të nenit 4.

4. Protokollat shtesë në lidhje me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi do të përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.



Këto protokolle shtesë do të hyjnë në fuqi në përputhje me të njëjtën procedurë të përcaktuar në paragrafin 1 të Nenit 4.

5. Kjo Marrëveshje do të ekzekutohet në dy kopje në gjuhën angleze, secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjithë së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtin instrument.

6. Palët deklarojnë se kanë lexuar përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje dhe konfirmojnë pëlqimin e tyre për përmbajtjen e saj, duke nënshkruar personalisht Marrëveshjen.

Datë

Datë

Peter Spišiak,
Ambasador i Republikës
Sllovaqe në Republikën e
Shqipërisë
në emër të
Lucia Kišš
Drejtor, Agjencia Sllovaqe
për Bashkëpunim
Ndërkombëtar të
Zhvillimit

Arben Ahmetaj
Ministri i Shtetit për
Rindërtimin
Këshilli i Ministrave të
Republikës
së Shqipërisë

VENDIM**Nr. 1162, datë 24.12.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
DHE TË AFATEVE PËR PAJISJEN ME
VËRTETIM PËR RISKUN TË
SUBJEKTEVE, TË CILAT KËRKOJNË TË
PAJISEN ME LEJE
ZHVILLIMI/NDËRTIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Të gjitha subjektet, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi ose leje ndërtimi, për të cilat nuk nevojitet pajisja paraprake me një leje zhvillimi, duhet që fillimisht të pajisen me një vërtetim për riskun nga organi kompetent që lëshon lejen, për të cilën këto subjekte paraqesin kërkesë.

2. Kërkesa për t’u pajisur me vërtetim për riskun bëhet *online* njëkohësisht me depozitimin e

dokumenteve të tjera të nevojshme për pajisjen me leje zhvillimi/ndërtimi pranë organit kompetent për lëshimin e një lejeje të tillë.

3. Ndërfaqja për vërtetimin e riskut të shtohet në bazën e të dhënave *e-Lejet* nga ana e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe administrohet nga organi përgjegjës për pajisjen me vërtetim për riskun.

4. Subjekti depoziton pranë organit kompetent për lëshimin e lejes së zhvillimit/ndërtimit, nëpërmjet portalit *e-Lejet*, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me leje zhvillimi/ndërtimi, kërkesën për t’u pajisur me këtë leje dhe kërkesën për t’u pajisur me vërtetimin për riskun, shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Afati ligjor i pajisjes me leje zhvillimi/ndërtimi fillon të llogaritet paralelisht me afatin për pajisje me vërtetim për riskun.

5. Organi kompetent, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e depozitimit të kërkesës nga subjekti, merr vendim për pajisjen e subjektit me vërtetimin për riskun, për pajisjen me vërtetim për riskun me ndryshime ose refuzon pajisjen me vërtetim për riskun.

6. Gjatë periudhës 45-ditore, organi mund të thërrasë palën kërkuese për sqarime ose të kërkojë dokumentacion shtesë, duke caktuar edhe një afat, jo më të gjatë se 5 (pesë) ditë, për vënien në dispozicion të këtij dokumentacioni.

7. Afati i përmendur në pikën 6, të këtij vendimi, pezullon afatin 45-ditor për t’u kthyer përgjigje subjekteve kërkuese. Pezullimi përfundon me vënien në dispozicion të dokumentacionit ose me skadimin e vetë afatit të caktuar nga organi për depozitimin e dokumentacionit.

8. Gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës, organi kompetent për pajisje me leje zhvillimi/ndërtimi mund të kërkojë ekspertizë teknike nga organe të tjera që kanë njohuri teknike mbi fushat për të cilat do të kryhet vlerësimi, për të lëshuar vërtetimin për riskun.

9. Fushat, mbi të cilat do të bazohet organi përgjegjës për të marrë një vendim për kërkesën e paraqitur nga pala kërkuese, të jenë sipas shtojcës 2, të këtij vendimi, dhe do të fokusohen në analizën e rrezikut, cënueshmërisë dhe ekspozimit të strukturës.

10. Vlerësimi i organit kompetent për lëshimin e vërtetimit të riskut do të bazohet në



dokumentacionin e nevojshëm të paraqitur nga pala kërkuese, siç është parashikuar në shtojcën 1, të këtij vendimi, ekspertizën e organeve të tjera, në rast se është kërkuar, si dhe në studimet për zonën ku do të zhvillohet projekti, për secilën fushë të sipërpërmendur.

11. Në fund të procedurës, organi administrativ përgjegjës për lëshimin e vërtetimit të riskut paraqet vendimin përfundimtar, të arsyetuar sipas shtojcës 3, të këtij vendimi.

12. Ndaj vendimit përfundimtar, pala kërkuese mund të ushtrojë ankim të drejtpërdrejtë në gjykatën administrative kompetente, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të vërtetimit, ose nga mbarimi i afatit të organit për të marrë një vendim dhe për të cilin ky i fundit nuk është shprehur.

13. Kërkesat për lejet e ndërtimit/zhvillimit, të cilat janë në shqyrtim nga organet kompetente në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të vijojnë të shqyrtohen pa u pajisur me vërtetim për riskun.

14. Ngarkohen Këshilli Kombëtar për Territorin, kryetarët e bashkive Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA 1 KËRKESË PËR PAJISJEN ME DOKUMENT PËR VËRTETIM PËR RISKUN

1. Emri i subjektit;
2. NUIS;
3. Projekti inxhinierik i certifikuar¹;
4. Studimi sizmologjik;
5. Studimi gjeologjik;

¹ Projekti duhet të përmbajë certifikimin e projektit të ndërtimit për qëndrueshmërinë ose elasticitetin ndaj riskut të lartë ndaj fatkeqësive, si dhe shpjegime për masat e marra në strukturë për përballimin e ekspozimit ndaj faktorëve të riskut, të evidentuar nga vetë projektuesi/zhvilluesi kërkuar, certifikimin e projektit të ndërtimit për qëndrueshmërinë ose elasticitetin ndaj riskut të lartë ndaj fatkeqësive.

6. Projekti teknik i sigurisë nga zjarri dhe shpërthimet, i miratuar nga shërbimi qendror i MZSH-së;

7. Plani kundër rrezatimit/ose vërtetim për mosekspozimin;

8 Studimi hidrik i ujërave nëntokësore dhe i burimeve ujore që mund të cenojnë zonën ku zhvillohet projekti.

SHTOJCA 2

A. Fushat për të cilat kërkohet vlerësimi i rrezikut që kërcënojnë veprën:

1. Rreziku sizmik;
2. Rreziku gjeologjik;
3. Rreziku nga zjarri;
4. Rreziku hidrologjik dhe i përmbajtje;
5. Rreziku nga rrezatimi.

Veprat, për të cilat paraqitet kërkesa për leje zhvillimi, do të vlerësohen nga organi kompetent shtetëror në 3 aspekte kryesore: analiza e riskut, cenueshmëria dhe ekspozimi.

1. Rreziku sizmik

Në varësi të tipit të strukturës, kërkesat për vlerësimin e rrezikut sizmik ndahen, si më poshtë vijon:

1.1 Kërkesa bazë në zbatim të standardit të projektimit për vlerësimin e rrezikut sizmik (si kusht minimal):

1. Vlerësimi i parametrin V_{s30} për klasifikimin e truallit me metoda sizmike (MASW ose *down-hole* ose *refraction*), sipas matjeve fushore në sheshin e ndërtimit dhe të dokumentuara në raportin teknik. Volumi i matjeve është në funksion të madhësisë së projektit (ndërtesë, bllok ndërtesash);

2. Vlerësimi i nxitimit maksimal të vibrimit të truallit për periudhë përsëritje 475 vjet;

3. Vlerësimi i nxitimit maksimal të vibrimit të truallit për periudhë përsëritje 95 vjet;

4. Spektrat elastikë horizontalë dhe vertikalë të reagimit për periudhë përsëritje 95 dhe 475 vjet, të vlefshëm për projektin e objektit në funksion të kategorisë së truallit.

1.2 Strukturat që duhet të plotësojnë kërkesat bazë të rrezikut sizmik:

1. Të gjithë tipat e ndërtesave me lartësi deri në 12 kate, ku, në bazë të karakteristikave të tyre, aplikohen koeficientët përkatës të rëndësisë të strukturës;



2. Veprat e transportit, ura hekurudhore ose automobilistike, ku, në bazë të karakteristikave të tyre, aplikohen koeficientët përkatës të rëndësisë të strukturës;

3. Vepra hidroteknike pa digë ose me digë më të vogël se 10 m (që përfshihen, sipas ICOLD, buletini 148, 2016, në diga “jo të mëdha”);

4. Strukturat ndihmëse dhe komponentët hidromekanikë dhe elektromekanikë të veprave hidroteknike pa digë ose me digë më të vogël se 10 m.

a) Kërkesa të avancuara në zbatim të standardeve shqiptare të projektimit dhe standardeve më të përparuara ndërkombëtare për vlerësimin e rrezikut sizmik

1. Për të gjitha ndërtesat dhe veprat që dalin mbi përcaktimet e bëra në pikën 1.2, të kësaj shtojce, do të aplikohen kërkesat e avancuara për vlerësimin e rrezikut sizmik të listuara më poshtë.

2. Punime sizmike me metodat MASË, refraction ose *down-hole* për vlerësimin e konfigurimit të shtresave, parametrin Vs30, parametrat e shpejtësisë të valëve sizmike P dhe S, për të mundësuar vlerësimin e moduleve dinamike.

3. Analiza e rrezikut sizmik të veprës, ku përfshihen:

i. aktiviteti sizmik dhe sizmotektonika e rajonit të projektit;

ii. vlerësimi probabilitar për periudha përsëritjeje deri në 10.000 vjet dhe determinist i rrezikut sizmik të sheshit të ndërtimit;

iii. deagregimi i rrezikut sizmik sipas nxitimit maksimal të vibrimit të truallit dhe SA nxitimit spektral për disa periudha përsëritjeje në funksion të projektit (në rastin e digave, për të 3 skenarët e shfrytëzimit dhe tërmetet e projektimit, kurse për ndërtesat e larta, deri në periodën themelore të vibrimit të strukturës).

4. Përzgjedhja e historive kohore të nxitimit për të mundësuar analizën jolineare të sjelljes së strukturës nga tërmetet e regjistruara në Shqipëri, të publikuara nga IGJEUM-i ose/edhe nga arkivat on-line evropiane ose botërore dhe përshtatja e tyre me kushtet reale të veprës në funksion të periudhës së përsëritjes, periodës së vibrimit dhe nivelit të shuarjes. Në funksion të kërkesave të investitorit, në rastin e digave të larta, mund të përdoren edhe historitë kohore sintetike.

b) Strukturat që duhet të plotësojnë kërkesa të avancuara për vlerësimin e rrezikut sizmik:

1. Vepra dhe ndërtesa, të cilat investitori i përcakton me rëndësi të jashtëzakonshme;

2. Të gjithë tipat e ndërtesave me lartësi më të madhe se 12 kate;

3. Vepra hidroteknike të përcaktuara si “diga të mëdha”, sipas ICOLD, buletini 148, 2016, me digë me lartësi më të madhe se 15 m;

4. Vepra hidroteknike të përcaktuara si “diga të mëdha”, sipas ICOLD, buletini 148, 2016, me lartësi midis 10 dhe 15 m, që plotëson një nga kriteret e mëposhtme:

4.1. Me gjatësi dige më të madhe se 500 m;

4.2. Me kapacitet të rezervuarit më të madh se $1 \times 10^6 \text{ m}^3$;

4.3. Me shkarkues me kapacitet që i tejkalon 2000 m^3 .

5. Strukturat ndihmëse dhe komponentë hidromekanikë dhe elektromekanikë të veprave hidroteknike të përcaktuara si “diga të mëdha”, sipas klasave të sigurisë të ICOLD, 2016, buletini 148;

6. Termocentrale të të gjitha madhësive;

7. Të gjitha strukturat gaz- dhe naftës-jellëse.

2. Rreziku gjeologjik

Studimet për vlerësimin e rrezikut gjeologjik do të kryhen duke u bazuar në disa kriteret, të cilat jepen, si më poshtë vijon:

1. Numri e punimeve zbuluese (shpime, puse gërmimi etj.) - shpërndarja dhe thellësia e tyre të bëhet, në përputhje me standardet e fazave të projektimit;

2. Duhet të respektohen standardet lidhur me provë marrjen, sasinë dhe vendin e marrjes së tyre, si dhe parametrat fiziko-mekanikë të nevojshëm për vlerësimin gjeoteknik të sheshit të ndërtimit në lidhje me qëndrueshmërinë shpatit;

3. Duhet të respektohen standardet lidhur me vlerësimin gjeologo-inxhinierik të trojeve me probleme gjeoteknike, të cilat ndërtohen nga depozitime kënetore dhe detare-kënetore (dhera organikë, torfa lyme etj.);

4. Vlerësimi dhe identifikimi i rrëshqitjeve të shpateve (të reja dhe të vjetra), duke përdorur studime komplekse gjeologo-inxhinierike (rilevime në shkallë 1:500–1:1000) dhe gjeofizike;

5. Identifikimi i thyerjeve tektonike në afërsi të veprës;

6. Vlerësimi dhe identifikimi i zonave me mundësi të ndodhjes së subsidencave në rajonet që ndërtohen nga formacione, të cilat karakterizohen



nga zhvillimi i fenomenit të karstit, duke përdorur studime komplekse gjeologo-inxhinierike (rilevime në shkallë 1:500–1:1000) dhe gjeofizike;

7. Studimet për vlerësimin e rrezikut gjeologjik do të kryhen nga ekspertë gjeologo-inxhinierikë të certifikuar, të cilët kanë mbaruar studimet e larta në nivelin “Master shkencor” ose doktoraturë në fushën e gjeologjisë inxhinierike dhe të kenë mbi 10 vjet eksperiencë në të tilla studime;

8. Testet për parametrat fiziko-mekanikë të dherave dhe shkëmbinjve duhet të bëhen në laboratorë të certifikuar;

9. Studime për vlerësimin e rrezikut gjeologjik duhet t’u nënshtrohen oponencave të kryera nga ekspertë të certifikuar në fushën e gjeologjisë inxhinierike.

2.1 Rreziku nga lëngëzimi i depozitimeve ku mbështeten objektet inxhinierike

Studimet për vlerësimin e rrezikut nga lëngëzimi do të jenë pjesë integrale e studimit gjeologjik dhe do të kryhen duke u bazuar në disa kriteret, të cilat jepen, si më poshtë:

1. Studimet për vlerësimin e mundësisë së ndodhjes të fenomenit të lëngëzimit duhet të kryhen në të gjitha depozitimet e pakonsoliduara, të cilat përfaqësohen nga dherat e tipit rërë dhe me thellësi të nivelit të ujërave nëntokësore më të vogla se 15 m;

2. Numri i punimeve zbuluese (shpime), shpërndarja dhe thellësia e tyre të bëhet në përputhje me standardet e fazave të projektimit;

3. Thellësia e studimit duhet të kryhet deri në 22 m në rastin kur depozitimet e pakonsoliduara kanë trashësi më të mëdha se 22 m dhe, në rastin kur trashësia e tyre është më e vogël se 22 m, studimi duhet të kryhet deri në shkëmbinj rrënjësorë.

4. Duhet të respektohen standardet në lidhje me provë marrjen, sasinë dhe vendin e marrjes së tyre, kryerjen e testeve fushore (SPT, CPT, Vs30), parametrat sizmikë për madhësinë e nxitimit të lëkundjes së truallit, si dhe parametrat fiziko-mekanikë të nevojshëm për vlerësimin gjeoteknik të sheshit të ndërtimit në lidhje me lëngëzimin;

5. Studimet për vlerësimin e mundësisë së ndodhjes të fenomenit të lëngëzimit duhet të kryhen nga ekspertë gjeologo-inxhinierikë, gjeoteknikë dhe sizmologë të certifikuar, të cilët kanë mbaruar studimet e larta në nivelin “Master shkencor” ose doktoraturë në fushën e gjeologjisë

inxhinierike, gjeoteknike dhe sizmologjisë dhe të kenë mbi 10 vjet eksperiencë në të tilla studime;

6. Testet për parametrat fiziko-mekanikë të dherave duhet të bëhen në laboratorë të certifikuar;

7. Studime për vlerësimin e mundësisë së ndodhjes të fenomenit të lëngëzimit duhet t’u nënshtrohen oponencave të kryera nga ekspertë të certifikuar në fushën e gjeologjisë inxhinierike, gjeoteknike dhe sizmologjisë.

3. Rreziku nga zjarri

Projekti teknik për sigurinë nga zjarri dhe shpërthimi duhet të analizojë dhe të certifikojë projektin për mbrojtjen nga zjarri e shpëtimi, sipas kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe të jenë të miratuara nga organi kompetent i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri, sipas ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

4. Rreziku hidrologjik dhe i përmbytjes

Në këtë kapitull duhet të përfshihen largësia e veprës nga digat, dambat etj., lloji i tokës, lumenj e depozita uji nëntokësore dhe mbitokësore, duke llogaritur mundësinë e aluvioneve e të përmbytjeve të mundshme dhe masat e mundshme për të shmangur zonat, në të cilat ka të dhëna statistikore që përforcojnë idenë e një probabiliteti të lartë të verifikimit të një situatë përmbytjeje. Në rast se në një zonë të caktuar ka rrezikshmëri të lartë nga përmbytjet, por nuk ka një ndarje të qartë të zonave ku do të jetë tërësisht i ndaluar zhvillimi dhe ku mund të zhvillohet, por duke marrë masa parandaluese shtesë, e gjithë zona objekt shqyrtimi do të trajtohet si me rrezikshmëri të lartë përmbytjeje. Pra, për të zhvilluar projekte ndërtimore në këto zona, projekti inxhinierik do të duhet të parashikojë masa specifike, duke marrë parasysh rrezikshmërinë e lartë nga përmbytjet.

Institucionet përgjegjëse për shqyrtimin dhe miratimin e lejes zhvillimore, për vlerësimin e parametrave të rrezikut hidrologjik dhe të përmbytjes, për vlerësimin e ekspozimit dhe të cenueshmërisë nga këto rreziqe duhet të bazohen në mendimin e organeve përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore, të cilat kanë në fushën e përgjegjësisë së tyre edhe menaxhimin nga përmbytjet, si dhe ekspertizën e organeve që administrojnë digat dhe dambat.

5. Rreziku nga rrezatimi

Subjektet që paraqesin kërkesë për “leje zhvillimi/ndërtimi”, duhet të përmbushin, krahas



gjithë detyrimeve të tjera për rreziqet e sipërpërmendura sizmike, gjeologjike etj., edhe detyrimet ndaj rrezikut që vjen prej rrezatimit, burimet e të cilit mund të jenë nga:

a) afërsia me institucionet që operojnë dhe kanë të domosdoshëm/domosdoshme përdorimin/nxjerrjen e lëndëve radioaktive (spitale, uzina, miniera, institucione kërkimi etj.);

b) nga afërsia me vendgrumbullimet e mbetjeve radioaktive, të sjella nga përdorues të ndryshëm;

c) nga përdorimi i materialeve të ndërtimit me nivel të lartë rrezatimi (të importuara etj.);

ç) nga rrezatimi që vjen prej afërsisë me sistemet kombëtare të transmetimit të energjisë (linjave të tensionit të lartë);

d) nga rrezatimi i emetuar prej antenave të transmetimit (të çdo natyre qoftë: radio, TV, telefoni celular etj.); si dhe

dh) burime të tjera të rrezatimit që mund të lindin gjatë zhvillimit e vënies në operim të objektit

apo të veprimtarisë për të cilën kërkohet “leje zhvillimi”.

B. Ekspozimi

Ekspozimi do të llogaritet si raport i vendndodhjes së strukturës objekt vlerësimi dhe të mbivendosjes hapësinore të gjurmëve të rrezikut të llogaritur në ndarjen A, të kësaj shtojce. Ekspozimi do të llogaritet për secilin element dhe do të përmbledhen në koeficiente, të cilat do të shërbejnë për të vlerësuar cenueshmërinë, siç parashikohet në nënndarjen e mëposhtme të kësaj shtojce.

C. Kërkesat për vlerësimin e cenueshmërisë (dëmtueshmërisë) së strukturave

1. Kërkesat ndaj projektit arkitektonik;
2. Kërkesat ndaj projektit konstruktiv;
3. Kërkesat ndaj projektit të themeleve.

Cenueshmëria do të llogaritet si përpjesëtim i masave të marra nga projektuesit për t'u rezistuar risqeve ndaj të cilave strukturat janë të ekspozuara, sipas koeficientëve të përlogaritur sipas ndarjes B

. SHTOJCA 3



Republika e Shqipërisë KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT/BASHKIA

VENDIM

Nr._____, datë _____.____._____

Bazuar në nenin 13, të ligjit, nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile” dhe në vendimin nr._____, datë_____.____._____, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi”,

Emri i subjektit:

Referencat: (të dokumentacionit për të cilin kërkohet vërtetimi për riskun, dokumentacioni që dorëzohet për t'u pajisur me leje zhvillimi dhe leje ndërtimi)

(Aryetimi), në bazë të vlerësimit, analizës, cenueshmërinë dhe ekspozimit ndaj rrezikut,

VENDOSI

Lëshohet vërtetimi për riskun/vërtetimi për riskun (me ndryshime)/nuk lëshohet vërtetimi për riskun.

KRYETARI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT/KRYETARI I BASHKISË

(Titullari i autoritetit përgjegjës për lëshimin e vërtetimit për riskun)



UDHËZIM

Nr. 2, datë 18.1.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 31, DATË 26.12.2013,
“PËR EMETIMIN NGA QEVERIA E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
TË OBLIGACIONEVE NË FORMË
REGJISTRIMI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe neneve 5 dhe 20, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 12, pikat 2 dhe 3 riformulohen si më poshtë:

“2. Në varësi të nevojave të huamarrjes dhe të kostos së saj, Ministria mund ta ndryshojë ose ta anulojë ofertën e shpallur. Në rastet kur shuma e kërkuar nga tregu është më e madhe ose e barabartë me ofertën e shpallur, Ministria mund të devijojë nga oferta e shpallur me maksimumin +/- 15%. Në rastet kur shuma e kërkuar nga tregu është më e vogël se oferta e shpallur, devijimi mund të jetë edhe më i lartë se sa -15% e ofertës së shpallur; në këtë rast MFE-ja ka të drejtën të ulë shumën e pranuar në ankand deri te shuma apo kërkesa ku fillon të zhvillohet *fat tail* (diferenca ndërmjet *yield-it cut-off* dhe *yield-it* mesatar të ponderuar).

3. Vendimi për devijimin do të mbështetet në cilësinë e kërkesave, jo në nivelin e *yield-eve*, duke synuar që *yield-i* maksimal i pranuar të jetë kufiri i fundit në shpërndarjen normale të serisë së *yield-eve* të kërkuara.”.

Neni 2

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 344, datë 31.12.2020

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS
PËR OPERATORIN E TURIZMIT
DETAR DHE FORMATIT
TË VETËDEKLARIMIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, pikës 6, të kreut I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 28.10.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Kodit të Etikës për Operatorin e Turizmit Detar që zhvillojnë aktivitete turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike, sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur.

2. Miratimi në formatit të vetëdeklarimit të operatorit të turizmit detar, sipas aneksit nr. 2 bashkëlidhur.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi



ANEKS 1
KODI I ETIKËS SË OPERATORIT TË
TURIZMIT DETAR

Neni 1
Qëllimi

Kodi i Etikës së Operatorit të Turizmit Detar që zhvillon aktivitete turistike detare të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për aktivitetet e turizmit detar bazohet në parimet dhe kriteret që zbatohen në praktikën më të mira ndërkombëtare, të cilat promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në përputhje me ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, kulturën dhe trashëgiminë, rritjen e sigurisë, përgjegjësisë sociale nga sipërmarrjet private, publike, turistët dhe/ose vizitorët.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Dispozitat e Kodit të Etikës zbatohen nga operatorët e turizmit detar që zhvillojnë aktivitete të turizmit detar, si dhe për atë që është e mundur nga sipërmarrje të tjera që bashkëveprojnë me to, turistët dhe/ose vizitorët.

Neni 3
Profesionalizmi dhe kujdesi social

1. Operatori i turizmit detar duhet të ushtrojë aktivitetin e tij në vendet të lejuara, sipas zonave të publikuara nga ministria përgjegjëse për turizmin.

2. Operatori i turizmit detar duhet të ofrojë një shërbim profesional, të kujdesshëm, të përkushtuar, me të njëjtin nivel e pa dallime për të gjithë turistët dhe/ose vizitorët, të cilëve u ofron shërbimin e tij.

3. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, operatori i turizmit detar, në marrëdhënien e tij profesionale me çdo turist/vizitor, duhet:

- a) të jetë i sjellshëm dhe miqësor;
- b) të mos konsumojë dhe të mos jetë asnjëherë nën efektin e alkoolit apo të ndonjë substance tjetër psikotrope, apo medikamenti që sjell ulje të aftësive logjike;
- c) të respektojë besimin fetar të çdo turisti/vizitori;
- ç) të respektojë personalitetin, zakonet, ritet dhe kulturën e çdo turisti/vizitori;

d) të jetë i kujdesshëm dhe i përgjegjshëm ndaj nevojave të çdo turisti/vizitori;

dh) të jetë i ndërgjegjshëm dhe i përgjegjshëm për sigurinë e çdo individit/vizitori;

e) të jetë i përpiktë, i besueshëm dhe i ndershëm;

ë) të kujdeset për higjienën e ambienteve të ofrimit të shërbimit;

6. Operatori i turizmit detar, në asnjë rast, nuk bën dallime diskriminuese ndaj ndonjë turisti/vizitori, sipas racës, gjinisë, orientimit seksual, besimit fetar, etnisë, gjuhës, kombësisë, bindjeve politike, filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale, aftësive fizike apo moshës.

7. Operatori i turizmit detar, në çdo rast, trajton dhe përpiket të zgjidhe një situatë konflikti me ndjeshmëri dhe përgjegjshmëri.

8. Operatori i turizmit detar respekton dhe zbaton legjislacionin kombëtar të punës dhe konventave ndërkombëtare, përfshirë rekomandimet e Organizatës Botërore të Punës dhe Organizatës Botërore të Turizmit të Kombeve të Bashkuara.

9. Operatori i turizmit detar promovon dhe respekton natyrën, historinë, trashëgiminë kulturore e shpirtërore, konsumimin e produkteve lokale, si dhe traditat lokale dhe në formë edukuese, përpiket t'i përçoje këto vlera tek turistët/vizitorët.

Neni 4
Edukimi dhe informimi

Operatori i turizmit detar, duhet të:

1. Vendosë në dispozicion të turistëve/vizitorëve informacionin në lidhje me turizmin, ekosistemet lokale dhe fenomenet mjedisore, që mund të përfshijnë gjithashtu një hartë me informacionet për zonën e operimit. Në varësi të madhësisë, modelit të mjeteve lundruese dhe llojit të aktivitetit turistik detar, mjetet dhe mënyrat e mëposhtme sugjerohen të jenë:

- a) bill bordet elektronike;
- b) posterë;
- c) fletëpalosje;
- d) prezantime video;
- e) librat;

f) udhërrëfyes audio dhe njoftime.

2. Publikojë në një vend të dukshëm për turistët/vizitorët, rregulla në lidhje me:

- a) asgjësimin e përshtatshëm të mbeturinave;



- b) politikën e pirjes së duhanit në bord;
- c) këshillat për sigurinë;
- d) sjelljen e përshtatshme gjatë një kontakti me kafshë të egra;

3. Ofrojë të paktën një aktivitet promovimi turistik dhe edukimi mjedisor për turistët/vizitorët, punonjësit dhe/ose komunitetin lokal brenda vitit ushtrimor të aktivitetit tregtar, në lidhje me:

- a) rritjen e ndërgjegjësimit dhe kujdesit për mjedisin lokal nga turistët/vizitorët dhe banorët;
- b) trajtimin e personelit në çështjet e turizmit të përgjegjshëm, kulturën, florën dhe faunën, menaxhimin mjedisor, shëndetin dhe mirëqenien;
- c) promovimin e turizmit dhe rekreacionit të qëndrueshëm në zonë.
- d) njohjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (SDG).

4. Shkëmbejë me strukturat përgjegjëse të turizmit të dhëna statistikore mbi turistët/vizitorët.

Neni 5

Siguria dhe mbrojtja e shëndetit të turistit/vizitorit

1. Operatori i turizmit detar, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, duhet të jetë i vëmendshëm ndaj çdo situatë të mundshme rreziku. Ai duhet të veprojë në mënyrë të përgjegjshme në çdo kohe, ambient e rrethane dhe duhet të jetë gjithmonë i kujdesshëm për sigurinë personale të turistit/vizitorit.

2. Operatori i turizmit detar duhet të kujdeset për të mos i dhënë mjekime një turisti/vizitori pa u konsultuar me mjekun.

3. Operatori i turizmit detar është i detyruar, të:

a) të raportojë pranë autoritetit më të afërt turistik dhe kur është rasti i parashikuar nga ligji, pranë çdo autoriteti policor, çdo incident me pasojë cenimin e integritetit moral, fizik, dëmtimin e shëndetit apo cenimin e jetës së turistit.

b) të zbatojë legjislacionin kombëtar, që lidhet me:

- i. siguri në teknike të mjeteve lundruese turistike;
- ii. informimin e turistëve/vizitorëve rreth çështjeve të sigurisë;
- iii. pajisjen me mjete teknike të mbrojtjes së jetës për çdo aksident që mund të ndodhë në bord;
- iv. pajisjen me mjete të ndihmës së parë;

v. pajisjen minimalisht me aparate fikse zjarri, të disponueshme në numër të përshtatshëm, lehtësisht të identifikueshme dhe të arritshme nga çdo drejtim i mjetit lundrues turistik;

c) të përgatisë planet e emergjencës për aksidente të ndryshme dhe trajnimin frekuent të burimeve njerëzore.

Planet e emergjencës duhet të përfshijnë minimalisht:

i. identifikimin e personave që duhen kontaktuar në rast aksidenti;

ii. angazhimin e shërbimeve administrative dhe personat e nevojshëm;

iii. procedurat për mbrojtjen, shpëtimin ose evakuimin e njerëzve në mjetin lundrues ose në ujë;

d) të publikojë, informojë personat në bord, me të dhëna dhe sinjalistikë që lidhen me lëvizjen në mënyrë të sigurt të mjetit lundrues, sjelljen e përgjegjshme gjatë motit të nxehët, udhëzim në lidhje me konsumin e alkoolit në bord (legjislacionin kombëtar për moshën minimale ligjore për konsumin), me vend ndodhjen e jelekëve të shpëtimit, pajisjeve zjarrfikëse dhe pajisjeve të ndihmës së parë, me paralajmërimin e vizitorëve për një situatë të pasigurt, vendndodhjen e ambienteve sanitare etj.

dh) të pajisë objektet sanitare me ujë të rrjedhshëm, detergjente dhe produkte të higjienës personale dhe ujë të pijshëm.

e) të mundësojë për personat me aftësi të kufizuara, aksesin e dedikuar në mjetet lundruese dhe në ambientet sanitare.

Neni 6

Njohja dhe respektimi i mjedisit

Operatori turistik detar, duhet të jetë i njohur dhe të zbatojë:

a) rregulloret përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushën mjedisore, fushën e trajtimit të ujërave të zeza, sigurisë, operimit detar, në lidhje me përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit etj.;

b) ruajtjen në struktura të ndara (kontejnerë) dhe asgjësimi me përgjegjësi i mbetjeve të rrezikshme, të krijuara në mjetet lundruese turistike dhe në ambiente ndihmëse;

c) ruajtjen e ujërave të zeza të papërpunuara në depozite të mjetit, të cilat duhet t'i nënshtrohen depozitimit dhe trajtimit të tyre në kompani të licencuara për trajtimin e ujërave. Në pamundësi të



trajtimit me kompani të licencuara, derdhja e ujit në mjedisin detar duhet të realizohet në përputhje me legjislacionin kombëtar ose ndërkombëtar, duke konsideruar ndër të tjera rregullat e MARPOL (shtojca I e MARPOL 73/78);

d) rregullat dhe standardet MARPOL dhe rregullorja e BE-së (KE) nr. 782/2003, në mbrojtje të mjedisit;

e) realizimin e punimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së mjetit lundrues, të cilat duhet kryhet në zona të përcaktuara, në port ose në vende ku nuk ka rrezik që substancat toksike të depërtojnë në ujë ose në tokë. Aktivitete më të mëdha riparimi (p.sh. kruarjes, lustrimit ose pastrimit ranor, lyerjes me sprucim dhe lyerje të mëdha, të cilat shkaktojnë ndotje pluhuri) duhet të bëhen në një ambient të mbuluar ose të mbyllur nën kushte të kontrolluara;

f) respektimin e kufizimeve të ankorimit për të mbrojtur shtratin detar, e në pamundësi, ankorimi në tokë solide të bëhet aty ku lejohet nga legjislacioni;

g) kujdesin dhe mirëmbajtjen e mjetit lundrues, derisa të transportohet në një subjekt të licencuar për trajtimin, në skadim të ciklit të jetës;

h) aplikimin e anketimeve vlerësuese dhe përdorimin e *feedback*-ut nga klientët, si një mënyrë për të vlerësuar performancën mbi plotësimin e pritshmërive mjedisore të vizitorit.

Neni 7

Veprimtaria e përgjegjshme mbi florën dhe faunën

Operatori i turizmit detar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, duhet të:

a) respektojë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për zonat e mbrojtura apo me status të veçantë ;

b) raportojë tek autoritetet përgjegjëse çdo shkelje të konstatuar, të kryer nga turistët/vizitorët;

c) minimizojë uljen e zhurmave, limitojë shpejtësinë e lundrimit (jo më e madhe se 5 nyje) gjatë afrimit për t'i vrojtuar speciet detare (pa i rrethuar, bllokuar ose ndjekur);

d) limitojë qëndrimin, i cili duhet të jetë jo më shumë se 20 minuta, nëse ka mjete të tjera lundruese në afërsi dhe jo më shumë se dy mjete lundruese në një rreze prej 1 km;

dh) marrë masa për ndalimin e hedhjes së ushqimit, shmangies së bazave të shumimit apo prekjes së specieve detare;

e) marrë masa për ndalimin e turistëve/vizitorëve lidhur me preken ose mbledhjen e specieve dhe bimëve, përveç:

i. peshkimit rekreativ në zonat e lejuara;

ii. ndërhyrjes së autorizuar nga strukturat e specializuara për shpëtimin e specieve detare;

ë) bashkëpunojë me institucionet kërkimore, duke ofruar infrastrukturën lundruese në funksion të kërkimit shkencor;

f) përmirësojë praktikat dhe produktet turistike, duke i bërë më shumë miqësore ndaj mjedisit;

g) raportojë tek autoritetet përgjegjëse, në rastet kur konstatohen specie të dëmtuara, të ngatërruara, të bllokuara ose të ngordhura.

Neni 8

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe historike

Operatorët e turizmit detar marrin përsipër të respektojnë:

1. Kufizimet që parashikohen nga kuadri ligjor në fuqi, që lidhen me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

2. Zakonet dhe traditat e zonës si dhe vendeve historike, arkeologjike dhe objekteve të tyre, duke mundësuar respektimin e tyre edhe nga turistët/vizitorët.

Neni 9

Marrëdhëniet ndërmjet operatorëve të turizmit detar

1. Operatorët e turizmit detar bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në mënyrë profesionale e me respekt dhe përpiqen të kultivojnë një marrëdhënie pozitive me të gjithë profesionistët e tjerë të përfshirë në një veprimtari turistike, me synimin për të promovuar trashëgimi në kulturore, historike dhe mjedisore të Shqipërisë.

2. Operatori i turizmit detar detyrohet të respektojë kërkimin e kryer dhe pronësinë intelektuale, materialet me të drejtë autori të operatorëve të tjerë, duke mos e regjistruar ose cituar pa autorizimin e autorit.



ANEKS 2
VETËDEKLARIM

Unë i/e nënshkruari/a _____ (emër/mbiemër), në cilësinë e përfaqësuesit ligjorë të subjektit _____ (emri i subjektit), me nr. NIPT-i _____, me adresë (adresa e plotë), me vullnet të lirë, deklaroj se jam njohur me kushtet, kriteret dhe kërkesat për ushtrimin e aktivitetit të turizmit detar dhe marr përsipër të zbatoj Kodin e Etikës së operatorit të turizmit detar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 845, datë 28.10.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktivitetëve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtim” dhe udhëzimit të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. _____, datë ____2020.

DEKLARUES
Emër Mbiemër Firmë

VENDIM
Nr. 266, datë 28.12.2020

**PËR MIRATIMIN E KODIT TË MATJES
SË GAZIT NATYROR NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 4, pika 33, 44; nenit 104, pika 1 dhe nenit 116, pika 4, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror me nr. 142/9 prot., datë 24.12.2020, “Për miratimin e kodit të matjes së gazit natyror” në Shqipëri,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 165 datë 22.10.2020, Bordi i ERE-s ka vendosur, “Fillimin e procedurës për shqyrtimin e draftit të ‘Kodit të matjes së gazit natyror’ në Shqipëri”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, u bënë publikimet në faqen e *web-it* të ERE-s, njoftimi në median e shkruar me shkresën e ERE-s nr. 62/32 prot., datë 2.11.2020, si dhe njoftimi për botimin në Fletoren Zyrtare me shkresën e ERE-s nr. 68/37

prot., datë 3.11.2020, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 195, datë 11.11.2020.

- Për të marrë opinionet e palëve të interesuara referuar vendimit të Bordi i ERE-s me nr. 165, datë 22.10.2020, ERE, me anë të shkresës nr.1160 prot., datë 2.11.2020, iu drejtua: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit të Konkurrencës (AK), Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, Anio Oil & Gas” sh.p.k., “Phoenix Petroleum” sh.a., “Albgaz” sh.a., “C.G.C” sh.p.k., “Balkgaz” sh.p.k., “TAP AGAlbania” sh.p.k, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë Elektrike, me qëllim që palët e interesuara të shprehnin, brenda 30 ditëve, opinionet dhe komentet e tyre.

- Në përfundim të afatit, me qëllim dhënien apo marrjen e mendimeve ose propozimeve, në lidhje me draftin e “Kodit të matjes të gazit natyror”, rezulton se me shkresën nr. 1520/1 prot., datë 1.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 1160/1 prot., datë 9.12.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Meterologjisë shprehet parimisht dakord për fillimin e kësaj procedure.

- “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 191/1 prot., datë 16.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 1160/1 prot., datë 16.12.2020, parashtron komentet dhe opinionet e trajtuara në relacionin përkatës, të cilat u morën parasysh edhe pse kishte kaluar afati i dorëzimit të tyre, në kuadër të gjendjes në kushtet pandemisë së COVID-19.

- ERE, nga komentet e propozuara nga “Albgaz” sh.a., ka pranuar dhe reflektuar në “Kodin e matjes së gazit natyror” pikat siç vijojnë:

- pikat: 2.1.2; 3.3.7; 5.1.1; Komente të përgjithshme; pikat: 3;4;6; Komente të veçanta; pikat: 1.4.1;2.1.1;2.1.2;2.4.1;2.7.2;2.7.3;2.7.5;3.2.3;3.3(a); 3.4.3;4.8;5.1.1; pikat: 30; 32; 33; 34; 35; 37 në relacion.

- ERE, nga komentet e propozuara nga “Albgaz” sh.a. nuk ka pranuar pikat siç vijojnë:

- pika 2.2.1; pika 5.1.2(h); komente të përgjithshme 2; 5, komente të veçanta, pikat: 1.5; 2.3.1;2.5.3;2.6.2;2.7.4;3.1.2;3.2.2;3.3.1;3.3.3;3.4.6;3.5.1;3.6.1;3.6.2;4.2.1;4.3.1;4.3.2;4.3.4;4.3.6(b);4.6.1;4.9.1;5.1.4; pikat 36 dhe 38 në relacion.

- Në datë 27.11.2020, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me anë të një *email-i* zyrtar parashtron komente dhe pyetje të cilat janë reflektuar të gjitha në “Kodin e matjes të gazit natyror” që janë pikat si vijon:



- Nuk rezulton të ketë asnjë koment, vërejtje apo sugjerim nga palë e tjera të interesit, në lidhje me përmbajtjen e draftit të “Kodit të matjes të gazit natyror” me të cilin Bordi i ERE-s ka filluar procedurën.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Kodit të matjes së gazit natyror” në Shqipëri.

2. Hyrja në fuqi e “Kodit të matjes së gazit natyror” do të jetë 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

3. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KODI I MATJES SË GAZIT

Tabela e përmbajtjes

1. HYRJE

1.1 Titulli

1.2 Autoriteti

1.3 Përkufizimet dhe interpretimi

1.4 Zbatimi

1.5 Marrja e një kopje të këtij “Kodi të Matjes së Gazit”

2. DISPOZITA E INSTALIMIT TË MATJES

2.1 Detyrimi për instalimin e matësve

2.2 Moskthimi

2.3 Sigurimi i instalimeve të matjes

2.4 Instalimi

2.5 Baza e të dhënave të instalimit

2.6 Standardet minimale të saktësisë

2.7 Siguria

3. TESTIMI I INSTALIMIT TË MATJES

3.1 Akreditimi dhe certifikimi

3.2 Testimi i pranimit dhe testimi i tipit të instalimeve të matjes

3.3 Detyrimi për të testuar instalimet e matjes

3.4 Klasat e matësve

3.5 Sigurimi i rezultateve të testit

3.6 Matës që nuk përputhen

3.7 Korigjimi

3.8 Vulosja dhe etiketimi

4. LEXIMI I MATËSIT DHE TË DHËNAVE

4.1 Ekuivalentimi i sasisë së gazit në energji

4.2 Leximi i matësit për transferimin e klientit

4.3 Mbledhja e të dhënave të matjes

4.4 Vlerësimi dhe zëvendësimi i të dhënave të matjes

4.5 Vlerësimi i të dhënave të matjes

4.6 Ruajtja e të dhënave të matjes

4.7 Hyrja në të dhënat e matësit

4.8 Konfidencialiteti

4.9 Pronësia e të dhënave të matjes

5. PLANI I MENAXHIMIT TË MATJES SË GAZIT

6. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

Përkufizimet

Interpretimi

Shtojca 1 – Vlerësimi, zëvendësimi dhe parashikimi – Instalimi i matësit me interval

1. Kërkesa për të vërtetuar leximet e matësve

2. Kërkesa për të prodhuar të dhënat matëse të zëvendësuar

3. Kërkesa për të prodhuar të dhëna të parashikuara të matjes

4. Detyrimet e transmetuesit ose shpërndarësit

5. Tipat e zëvendësimit dhe parashikimit

Shtojca 2 – Vlerësimi, zëvendësimi dhe parashikimi – Instalimi i matësit bazik

1. Kriteret për të vlerësuar leximet e matësve

2. Kriteret për të prodhuar të dhënat matëse të zëvendësueshme

3. Kriteret për të prodhuar të dhëna të vlerësuar të matjes

4. Detyrimet e shpërndarësit

5. Tipat e zëvendësimit dhe vlerësimit

1. HYRJE

1.1 Titulli

1.1.1 Ky Kod është “Kodi i matjes së gazit”.

1.2 Autoriteti

1.2.1 “Kodi i matjes së gazit” është bërë në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe si pjesë e veçantë nga “Kodi i transmetimit të gazit” në Shqipëri.



1.3 Përkufizimet dhe interpretimi

1.3.1 Fjalët që shfaqen me shkronja të zeza si këto janë përcaktuar në pikën 6, të këtij “Kodi të matjes së gazit”.

1.3.2 Kodi duhet të interpretohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në pikën 6, të këtij “Kodi të matjes së gazit”.

1.4 Zbatimi

1.4.1 “Kodi i matjes së gazit” rregullon kërkesat teknike për matësit dhe instalimet e matjes në pikat e transmetimit dhe/ose shpërndarjes së klientit.

1.4.2 Personat e lidhur me këtë Kod janë tregtar me pakicë dhe/ose shumicë, si dhe OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar.

1.5 Marrja e një kopje të këtij “Kodi të matjes së gazit”

1.5.1 Një OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, kur i kërkohet nga një klient, t’i dërgojë atij klienti, brenda 10 ditëve të punës, një kopje të këtij “Kodi të matjes së gazit” (dhe çdo ndryshim të bërë kohë pas kohe që ndikon materialisht në të drejtat, privilegjet ose detyrimet e një konsumatori), pa tarifë për kërkesën për herë të parë nga ai klient.

2. DISPOZITA E INSTALIMIT TË MATJES

2.1 Detyrimi për instalimin e matësve

2.1.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë një instalim të matjes së intervalit në pikat e transmetimit ose shpërndarjes për të cilat niveli vjetor i konsumit të gazit është më i madh se kwh/vit , ose nm^3/vit në vit, dhe pritet të mbetet më i lartë se kwh/vit , ose nm^3/vit .

2.1.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar nuk duhet ta mbajë peng miratimin e tij për kërkesën e ardhur nga një tregtar me pakicë që kërkon të instalojë një sistem matje të ndryshëm nga ai që është i instaluar, ose të ndryshëm nga ai lloj matësi që do të instalonte OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar, me kusht që instalimi i matjes të plotësojë çdo kërkesë teknike të zbatueshme (përfshirë ato që kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar).

2.1.3 Kostoja shtesë e sigurimit dhe instalimit të një sistemi të ri matës, sipas pikës 2.1.2, do të paguhet nga pala që fillon ndryshimin, në masën e lejuar nga një tarifë.

2.2 Moskthimi

2.2.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që një sistem i matjes së intervalit të mos zëvendësohet nga një sistem bazë i matjes para fundit të jetës së tij ekonomike, përveç rastit kur transmetuesi dhe shpërndarësi do të kishte përcaktuar që konsumi i gazit në pikën e transmetimit dhe/ose shpërndarjes do të ulet nën kwh/vit , ose nm^3/vit në vit, për shkak të ndryshimeve të rëndësishme në përdorimin e pajisjeve.

2.2.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të raportojë në ERE, gjatë periudhës së aprovimit të investimeve, të gjitha rastet kur ai ka zëvendësuar një matës intervali me një matës bazik, në përputhje me përcaktimin e OST-së, OSSH-së dhe/ose Operatorit të Kombinuar, të bërë në pikën 2.2.1.

2.3 Sigurimi i instalimeve të matjes

2.3.1 Një sistem i matjes duhet të përmbajë një regjistër të dhënash që:

a) të jetë i dukshëm dhe i arritshëm për të lexuar të dhënat e matësit;

b) lejon që të dhënat e matësit të aksesohen dhe lexohen në kohë reale nga një kompjuter apo pajisje të llojeve apo specifikime të tjera, të pranueshme në mënyrë të arsyeshme për të gjithë personat që kanë të drejtë të kenë qasje në ato të dhëna të matjes.

2.4 Instalimi

2.4.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të instalojë matësit sa më afër që të jetë e mundur në pikën e livrimit.

2.4.2 Shpërndarësi OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të instalojë matës në një pozicion i cili lejon qasje të sigurt dhe të papenguar për çdo person, detyrimi i të cilit është të testojë, rregullojë, mirëmbajë, riparojë ose zëvendësojë instalimin e matjes, ose të mbledhë të dhëna matëse nga sistemi i matjes.

2.5 Baza e të dhënave të matjes

2.5.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të mbajë një bazë të të dhënave të sistemit të matjes, në lidhje me secilin instalim të matjes.

2.5.2 Baza e të dhënave të instalimit duhet të përmbajë të paktën informacionin vijues:

a) Numrin e Regjistrimit të Instalimit të Matjes (NRIM);

b) Vendndodhjen e secilit matës të instaluar, korrigjuesit dhe regjistruarit të të dhënave;



c) Markën, modelin dhe vitin e prodhimit për secilin matës, korrigjues dhe regjistruar të të dhënave;

d) Për secilin matës, korrigjues dhe regjistruar të dhënash që është instaluar, adresën e klientit dhe datën e instalimit;

e) Datën e planifikuar për testimin ose zëvendësimin e të gjitha pajisjeve të përdorura për të matur sasinë e gazit;

f) Të dhëna për performancën e secilës pajisje të përdorur për të matur sasinë e gazit (kur është e përshtatshme);

g) Regjistrat e kalibrimit të të gjitha pajisjeve të përdorura për të matur sasinë e gazit;

h) Regjistrat e testimin të të gjitha pajisjeve të përdorura për të matur sasinë e gazit;

i) Datën dhe detajet e të gjitha vulave dhe etiketave të aplikuara të matësit dhe të korrigjuesit;

j) Datën dhe detajet e mirëmbajtjes më të fundit të të gjitha pajisjeve të përdorura për të matur sasinë e gazit; dhe

k) Datën tjetër të planifikuar për mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve të përdorura për të matur sasinë e gazit.

2.5.3 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të ruajnë informacionin që përmbahet në bazën e të dhënave të instalimit:

a) në një format të arritshëm, për një periudhë minimale prej 16 muajsh nga data e përfshirjes së informacionit në bazën e të dhënave; dhe

b) në arkiv, për 7 vjet nga data e përfshirjes së informacionit në bazën e të dhënave, ose për dymbëdhjetë muaj pas jetës së instalimit të matësit përkatës, cilado që është më e gjatë.

2.5.4 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojnë, pas marrjes së kërkesës me shkrim, akses në informacionin e të dhënave në instalimin përkatës, të palës së prekur:

a) brenda dy ditëve të punës, kur informacioni është në një format të arritshëm siç kërkohet në pikën 2.5.3 (a); dhe

b) përndryshe brenda tridhjetë ditëve të punës, nga data e marrjes së kërkesës.

2.6 Standardet minimale të saktësisë

2.6.1 Standardet minimale të saktësisë për instalimet e matjes janë brenda një kufiri saktësie plus ose minus 2% të vëllimit neto të gazit të dorëzuar në atë pikë të dërgesës.

2.6.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që funksionimi i

instalimit të matjes nuk tregon ndikim sistematik brenda kufijve të lejuar të saktësisë.

2.6.3 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që secili prej instalimeve të tij të matjes që përmbajnë rregullatorë presioni janë në gjendje të sigurojnë rrjedhje të mjaftueshme në presionin minimal të hyrjes së rregullatorit, dhe kur zbatohet një faktor i fiksuar i presionit, është në gjendje të kontrollojë me besueshmëri presionin e daljes për të përmbushur kërkesat e instrumenteve të aplikueshme rregullatore.

2.6.4 Një person i lidhur me këtë kod nuk duhet të ndërhyjë ose të kalibrojë një matës, me qëllim të futjes së ndikuesve në matës.

2.7 Siguria

2.7.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të bëjnë përpjekjet më të mira për të siguruar që instalimi i matjes të mbrohet nga ndërhyrjet ose dëmtimet e paautorizuara.

2.7.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, që në lidhje me instalimet e reja të matjes, të sigurojë vula ose elemente të tjera sigurie që mundësojnë evidentimin e çfarëdo ndërhyrje në matës.

2.7.3 Pas njoftimit se një vulë është thyer, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të zëvendësojë një vulë të prishur më herët se:

a) rasti i parë që vizitohet instalimi i matjes për të lexuar; ose

b)

2.7.4 Shpenzimet e zëvendësimit të vulave të prishura përballohen si më poshtë:

a) nëse vula është thyer nga klienti, paguhet nga klienti; ose

b) nëse vula është thyer nga tregtari me pakicë dhe shumicë, paguhet nga tregtari me pakicë dhe/ose shumicë, ose

c) përndryshe nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar

2.7.5 Nëse si rezultat i ose në lidhje me prishjen ose dëmtimin e një vule, matësi përkatës mund të mos përmbushë më standardet përkatëse minimale të saktësisë, OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet:

a) testojë matësin në përputhje me klauzolën 3, brenda 15 ditëve të punës; ose

b) të zëvendësojë matësin në përputhje me pikën 3.6.



3. TESTIMI I INSTALIMIT TË MATJES

3.1 Akreditimi dhe certifikimi

3.1.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që matësit dhe korigjuesit e blerë të kenë miratimin e modelit të Drejtorisë së Standardeve dhe të Matjes nga një laborator i akredituar i njohur sipas Skemës Ndërkombëtare të Certifikimit, në përputhje me specifikimet ose udhëzimet e specifikuara nga Drejtoria e Standardeve dhe e Matjes.

3.1.2 Aty ku aprovimi i modelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Meteorologjisë nuk kërkohet të sigurohet nga institucion tjetër, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të kryejë teste, ose duhet të bëjë që testet të kryhen, në lidhje me vendosjen, kalibrimin ose vërtetimin e saktësisë së matësve dhe korigjuesve, nga persona, ose në një strukturë, të akredituar nga DPM-j për të kryer teste të tilla.

3.1.3 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që pajisjet e kalibrimit, të përdorura në lidhje me kalibrimin e instalimeve të tyre matëse, janë të certifikuara nga një autoritet verifikues i autorizuar për të lëshuar certifikata sipas Rregullores DPM.

3.2 Testimi i pranimit dhe testimi i tipit të instalimeve të matjes

3.2.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të kryejë, ose të insistojë që të kryhet, teste të pranimit në matës, korigjues dhe regjistruerit e të dhënave që janë përbërës të instalimeve të matjes në rrethanat e mëposhtme:

a) përpara se një matës i ri, korigjuesi ose regjistruerit i të dhënave të vendoset në shërbim;

b) përpara se një matës, korigjuesi ose regjistruerit i të dhënave që është hequr nga shërbimi të vendoset përsëri në shërbim; dhe

c) pasi të ketë përfunduar çdo riparim, mirëmbajtje ose rikalibrim i kryer në një matës, korigjues ose regjistruerit të dhënash.

3.2.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të miratojë një lloj të ri të sistemit të matjes vetëm nëse ai instalim i matjes i është testuar tipi.

3.2.3 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet t'i

një përdoruesi të sistemeve të tyre,

kopjet e certifikatave përkatëse të testit të tipit që disponon, në lidhje me matësin sipas kërkesës.

3.2.4 Transmetuesi dhe/ose shpërndarësi duhet të mbajë regjistrime të testimit të tipit, sipas pikës 3.2.2, ndërsa matësit e atij lloji mbeten në shërbim, ose për një minimum prej 7 vjetësh, cilado që të jetë më e gjatë.

3.2.5 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që çdo matës që është modifikuar të vlerësohet për të përcaktuar nëse modeli i modifikuar vazhdon të përmbushë standardet minimale të përshkruara nga ky “Kod i matjes” dhe që matësit nuk ndryshojnë nga prova e llojit të tyre në masën që çdo ndryshim do të ndikonte në performancën e matësve.

3.2.6 Nëse ekzistojnë baza të arsyeshme për të konkluduar se modifikimet në një matës ndikojnë në aftësinë e tij matëse ose në testimin fillestar të llojit të tij, atëherë OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që instalimi i matjes të dorëzohet për test të tipit.

3.3 Detyrimi për të testuar instalimet e matjes

3.3.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të vendosë në çdo kohë, dhe duhet që brenda 15 ditëve të punës nga kërkesa e një tregtari me pakicë ose shumicë, të testojë një instalim matës për të konstatuar nëse instalimi i matjes është apo jo i demtuar.

3.3.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet t'i japë tregtarit me pakicë ose shumicë, që kërkon një test, njoftim të paktën 5 ditë pune (ose bien dakord reciprokisht për një kohë tjetër të përshtatshme) se kur propozohet të kryhet testi i kërkuar.

3.3.3 Nëse si rezultat i testit të kërkuar nga një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë, sipas pikës 3.3.1, instalimi i matjes rezulton të jetë:

a) me defekt, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të mbulojë shpenzimet e bëra gjatë kryerjes së provës; ose

b) pa defekt, transmetuesi ose shpërndarësi mund të kërkojë të rikuperojë koston e kryer gjatë kryerjes së provës.

3.3.4 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të publikojë tarifa për testimin e instalimeve të matjes. Tarifat duhet të jenë të drejta dhe të arsyeshme.

3.3.5 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar, sipas kërkesës, duhet t'i sigurojë tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë rezultatet e



testit të kryer, sipas pikës 3.3.1, brenda 5 ditëve të punës.

3.3.6 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të mbajë regjistrime të testeve në përputhje me pikën 2.6.

3.4 Klasat e matësve

3.4.1 Periudha fillestare në shërbim e një klasë matësish është një periudhë e aprovuar nga DPM-ja që fillon në ditën kur një matës në atë klasë matësi u përdor për herë të parë në furnizimin me gaz të një klienti.

3.4.2 Nëse një transmetues dhe/ose shpërndarës synon të mbajë matësit në një klasë matësi pas përfundimit të periudhës fillestare të shërbimit për atë klasë matësi, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, përveç dispozitave të tjera të testimit të matësit në këtë kod, të krijojë dhe mirëmbajë një plan të testimit dhe marrjes së mostrave të aprovuar nga DPM-ja.

3.4.3 Plani i testimit dhe i marrjes së mostrave duhet të parashikojë që matësit të testohen si në 20% dhe 100% të kapacitetit nominal të matësve.

3.4.4 Kërkesat minimale të provës do të jenë në përputhje me standardet e DPM-së.

3.4.5 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatorit të Kombinuar i kërkohet që t'i sigurojë rezultatet e provave për të dy kapacitetet 20% dhe 100% për atë klasë matësi.

3.4.6 Nëse rezultatet e testit nuk përmbushin:

a) kufijtë maksimalë të lejueshëm të gabimit, për kapacitetin nominal të matësve në 20% dhe në 100%, siç përcaktohet në pikën 2.6, me një kufi pasigurie prej jo më shumë se 1%; dhe

b) kërkesa të tilla të tjera të planit të testimit dhe të marrjes së mostrave, të miratuara nga DPM-ja, atëherë OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të zëvendësojnë ose rikalibrojë të gjitha instalimet e matjes në atë klasë të matësve.

3.5 Sigurimi i rezultateve të testit

3.5.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, me kërkesë të DPM-së, t'i sigurojë ERE-s rezultatet e çdo prove të kryer në përputhje me këtë kod të matjes.

3.6 Matës që nuk përputhen

3.6.1 Nëse saktësia e një instalimi matësi nuk përputhet me kërkesat e këtij kodi të matjes, ose nëse një transmetues dhe/ose shpërndarës bëhet i vetëdijshëm për ndonjë çështje që mund të ndikojë në integritetin e të dhënave të matjes, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të

mbulojë, me koston e OST-së, OSSH-së dhe/ose Operatorit të Kombinuar:

a) njoftojë palët e prekura sa më shpejtë të jetë e mundur;

b) rregullojë që saktësia e instalimit të matjes të rikthehet në mënyrë që ajo të përmbushë standardet minimale të saktësisë, ose që instalimi i matjes të zëvendësohet, brenda 10 ditëve të punës, kur konsumi në pikën e transmetimit dhe/ose të shpërndarjes është më pak se 10 tj për vit, dhe 5 ditë pune kur konsumi në pikën e transmetimit dhe të shpërndarjes është 10 tj në vit ose më shumë, ose një periudhë më e gjatë që mund të aprovohet nga ERE; dhe

c) deri në restaurimin ose zëvendësimin e instalimit të matjes, në përputhje me klauzolën 3.6.1 (b) përdorimi i leximeve zëvendësuese.

3.6.2 Kur ekziston një gabim i matjes dhe OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar propozon të zëvendësojë leximet e mëparshme të matësit, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të kufizojë zëvendësimin e leximeve të matësve në:

a) periudha kur gabimi i matjes ishte më i madh se 1.5 herë standardet minimale të saktësisë; dhe

b) periudhën kur ekziston gabimi i matjes, por jo më herët se 12 muaj para se të dihej gabimi i matjes nëse gabimi i matjes rezultoi në nën faturimin e klientit.

3.7 Korrigjimi

3.7.1 Gjatë ndërmarrjes së një leximi të matësit në një instalim matës, OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të rregullojë leximin e matësit për presionin, temperaturën ose mbipresionin e lejuar, ose një kombinim të këtyre faktorëve, përmes aplikimit të faktorëve të korrigjimit ose përdorimit të një korrigjuesi kur:

a) gabimi që rrjedh nga këto efekte tejkalon kërkesat e standardeve minimale; ose

b) gjendja e funksionimit ndryshon gjatë ditës duke ndikuar në presionin, temperaturën ose mbipresionin; ose

c) kur kërkohet ta bëjë këtë nga ERE.

3.7.2 Një OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të bëjë një rregullim për gabimin e matësit duke përdorur një korrigjues ose një faktor korrigjimi kur:

a) korrigjuesi dhe matësi për korrigjimin e specifikuar është identifikuar në mënyrë unike;



b) saktësia e matësit dhe/ose korrektorit është brenda standardeve minimale;

c) metoda e rregullimit nga korrigjuesi mund të ndryshojë; dhe

d) palët e prekura këshillohen për pajisjen e kompensimit dhe cilësimet e përdorura.

3.8 Vulosja dhe etiketimi

3.8.1 Një OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të vendosë një etiketë në çdo matës dhe korrigjues që i është nënshtruar një testi të pranimit dhe që rezulton se e ka kaluar testin. Etiketa duhet të përmbajë një shenjë dalluese dhe vitin e provës të bashkangjitur për të treguar se ajo e ka kaluar testin.

3.8.2 Nëse një matës ose korrigjues nuk është testuar ose është gjetur që nuk ka kaluar një test pranimi, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që nuk është etiketuar.

4. LEXIMI I MATËSIT DHE TË DHËNAVE

4.1 Ekuivalentimi i sasisë së gazit në energji

4.1.1 Gazi duhet të matet me sasi dhe të shndërrohet në njësi të energjisë për qëllime faturimi duke përdorur vlerën e ngrohjes së llogaritur nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar në përputhje me një metodologji të miratuar nga ERE.

4.2 Leximi i matësit për transferimin e klientit

4.2.1 Sipas kërkesës nga një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të bëjnë përpjekjet më të mira për të kryer një lexim aktual të matësit për të mundësuar transferimin e një klienti tek ai tregtar me pakicë dhe/ose shumicë brenda një kohe të arsyeshme të kërkesës.

4.2.2 Aty ku është instaluar një matës bazë, leximi përfundimtar i matësit para se një klient të transferohet në një shitës të ri pakice ose shumice, qoftë një lexim i planifikuar i matësit apo një lexim i veçantë i tij, duhet të dërgohet nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar të shitësi i ri me pakicë dhe/ose shumicë, në përputhje përkatësisht me klauzolën 4.7.4 ose klauzolën 4.7.5.

4.3 Mbledhja e të dhënave të matjes

4.3.1 Në varësi të pikave 4.3.2 dhe 4.3.3, një klient mund të rregullojë me tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë mënyrën në të cilën të dhënat e ruajtura në një matës, të ofruara për klientin, do të

mblidhen nga OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar.

4.3.2 Një klient mund të kërkojë që të dhënat e ruajtura në instalimet e matjes të mblidhen nga OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar:

a) duke inspektuar instalimin e matjes; ose

b) kur instalimi i matjes është i aftë të sigurojë të dhëna me mjete elektronike, me mjete elektronike; ose

c) kur instalimi i matjes është i aftë të sigurojë të dhëna me ndonjë mjet tjetër, me ndonjë mjet tjetër.

4.3.3 OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të faturojë një tregtar me pakicë dhe/ose me shumicë për mbledhjen e të dhënave të matjes, sipas kësaj klauzole 4.3.2, në masën që kostot e tij të mbledhjes janë më të larta se sa do të ishin përndryshe.

4.3.4 Kur të dhënat e matësit të mbajtura në instalimin e matjes janë të mbrojtura nga qasja e drejtpërdrejtë ose e largët e fjalëkalimeve të përshtatshme dhe kontrollet e sigurisë, fjalëkalimet dhe kontrollet e tilla të sigurisë duhet të përdoren.

4.3.5 Fjalëkalimet duhet të trajtohen si informacione konfidenciale në përputhje me pikën 4.8.

4.3.6 Nëse ka ndonjë mospërputhje, midis:

a) të dhënave të ruajtura në një instalim matës; dhe

b) të dhënave të matësit në lidhje me atë instalim të matjes, të dhënat e ruajtura në instalimin e matjes duhet të jenë prova e parë e sasisë së gazit ose energjisë, nëse është e zbatueshme, furnizuar te klienti përkatës.

4.4 Vlerësimi dhe zëvendësimi i të dhënave të matjes

4.4.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që të dhënat e matësit, të mbledhura nga një instalim i matjes së intervalit, sipas pikës 4.3:

a) është vërtetuar në përputhje me programin 1, klauzola 1, të këtij “Kodi të matjes”; dhe

b) kur është e nevojshme, zëvendësohet në përputhje me programin 1, pikat 2 dhe 4, të këtij kodit të industrisë.

4.4.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që të dhënat e matësit të mbledhura nga një instalim bazë i matjes, sipas pikës 4.3:

a) është vërtetuar në përputhje me programin 2, klauzola 1, të këtij “Kodi të matjes”; dhe



b) kur është e nevojshme, zëvendësohet në përputhje me programin 2, klauzola 2 dhe 4, të këtij “Kodi të matjes”.

4.4.3 Kur testet, sipas pikës: 4.4.1 (a) ose 4.4.2 (a), tregojnë se ka pasur një dështim të instalimit të matjes ose se ekziston një gabim i matjes, të dhënat e matësit duhet të zëvendësohen në përputhje me pikën 4.4. 1(b) ose 4.4.2 (b) dhe OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet t’i sigurojë tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë të dhënat e matura, të zëvendësuara në mënyrë që tregtari me pakicë ose shumicë të mund të përmbushë detyrimet e tij të faturimit.

4.4.4 Nëse bëhet një zëvendësim i të dhënave të matjes, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të informojë tregtarin në përputhje me rrethanat për t’u siguruar që një faturë e lëshuar për klientin përkatës e informon atë klient se është bërë një zëvendësim.

4.4.5 Kur të dhënat e matësit në lidhje me një klient janë zëvendësuar dhe kërkohet të transferohen tek ERE, të dhënat e zëvendësuara duhet t’i sigurohen ERE-s nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar

4.4.6 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të mbajë një regjistër të veçantë të zëvendësimit të bërë në pikat: 4.4.1 dhe 4.4.2, për 7 vjet, dhe të sigurojë hyrjen në regjistër në kohë të arsyeshme për tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë të klientit përkatës.

4.5 Vlerësimi i të dhënave të matjes

4.5.1 Në varësi të pikave 4.3.2 dhe 4.3.3, një klient mund të rregullojë me tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë mënyrën në të cilën të dhënat e ruajtura në një instalim matës, të ofruara për klientin, do të mbledhen nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar.

4.6 Ruajtja e të dhënave të matjes

4.6.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të ruajë të dhënat e matësit, në lidhje me instalimet e ndara të matjes, në formën në të cilën janë mbledhur, sipas pikës 4.3:

a) në një format të arritshëm për një periudhë minimale prej 16-muajsh nga data e leximit të matësit; dhe

b) në arkiv, për 7 vjet nga data e leximit të matësit.

4.7 Hyrja në të dhënat e matësit

4.7.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet t’i japin klientit të një tregtari me

pakicë dhe/ose shumicë aksesin në të dhënat e ruajtura në një matës të përdorur për të matur dhe regjistruar sasinë e gazit të furnizuar në pikën e tij të transmetimit ose të shpërndarjes, ose duke inspektuar instalimin e matjes ose, kur është e mundur, nga qasja elektronike në sistemin e matjes.

4.7.2 Kur të dhënat janë në dispozicion me mjete elektronike, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, me kërkesë me shkrim nga tregtari me pakicë dhe/ose shumicë i klientit, të sigurojë lehtësira për t’i mundësuar klientit të ketë qasje në të dhënat e ruajtura në një instalim matës, ku ato janë në dispozicion me mjete elektronike.

4.7.3 Kur OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar ka siguruar lehtësira për t’i mundësuar klientit të tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë të ketë qasje në të dhënat e ruajtura në një instalim matës me mjete elektronike të largëta, nëse qasja elektronike në distancë në instalimin e matjes është e padisponueshme për një periudhë prej 5 ditësh pune radhazi për shkak të veprimeve brenda kontrollit të OST-së, OSSH-së dhe/ose Operatorit të Kombinuar, duhet, nëse kërkohet nga klienti i tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë, të marrë të dhëna në nivel lokal nga instalimi i matjes dhe t’ia sigurojë ato të dhëna klientit të tregtarit me koston e OST-së, OSSH-së dhe/ose Operatorit të Kombinuar.

4.7.4 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që ofrohet qasje për tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë në të dhënat e matësit (qofshin ato aktuale, të zëvendësuara sipas pikës 4.4 ose të vlerësuara sipas pikës 4.5), në frekuencën e rënë dakord, nga ora 17.00 në ditën e parë të punës pas mbledhjes së të dhënave të matjes.

4.7.5 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që tregtari me pakicë dhe/ose shumicë t’i sigurohet aksesin në të dhënat e matësit nga leximet speciale të matësve dhe leximet përfundimtare të matësve, deri në orën 17.00 ose ditën e parë të punës pas mbledhjes së të dhënave të matjes.

4.7.6 Kur ofrohet akses për tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë në të dhënat e matësit sipas pikave 4.7.4 dhe 4.7.5, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që të jepjen të dhëna shtesë që kërkohen nga tregtari me pakicë dhe/ose shumicë për të përmbushur



detyrimet e tij sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

4.8 Konfidencialiteti

4.8.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar dhe tregtari me pakicë dhe/ose shumicë duhet të mbajnë konfidenciale të dhënat e matësit dhe të bëjnë përpjekjet më të mira për të mbrojtur dhe ruajtur natyrën konfidenciale të të dhënave të matjes dhe duhet të jenë në përputhje me çdo instrument rregullator të zbatueshëm.

4.8.2 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar dhe tregtari me pakicë dhe/ose shumicë:

a) nuk duhet të zbulojnë të dhëna për matjen e një klienti te ndonjë person përveç rastit kur lejohet nga ky “Kod i matjes”, ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, Rregullorja e gazit, ose rregullat e tregut me shumicë dhe pakicë;

b) nuk duhet të përdorin ose riprodhojnë të dhëna matëse vetëm për një klient për qëllimin për të cilin janë mbledhur nën këtë kod të matjes ose një qëllim tjetër të parashikuar nga kodi i transmetimit dhe i shpërndarjes së gazit, ose procedurat e tregut me pakicë dhe shumicë;

c) nuk duhet të lejojnë persona të paautorizuar të kenë akses në të dhënat e matësit për një klient;

d) nuk duhet të zbulojnë të dhëna për matjen e një klienti te çdo person pa pëlqimin e qartë të klientit; dhe

e) duhet të sigurojnë që të dhënat e matësit dhe informacioni tjetër i marrë nga një klient të trajtohet në përputhje me pëlqimin e qartë të informuar të klientit dhe në përputhje me çdo akt rregullator të zbatueshëm.

4.8.3 Kjo klauzolë 4.8 nuk parandalon:

a) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes nëse të dhënat e matësit janë në atë kohë në dispozicion në përgjithësi dhe publikisht ndryshe nga sa rezultati i shkëljes së besimit nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar ose një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë ose zbulimi i tij;

b) zbulimi i të dhënave të matjes nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar ose një shitës me pakicë ose shumicë ose zbulimi i tij për:

i. punonjësit e saj ose punonjësit e organeve të tij përkatëse të shoqërisë, subjekt i ndonjë akti rregullues të zbatueshëm;

ii. ose këshilltari i tij ligjor ose tjetër profesional, auditor ose këshilltar tjetër, që kërkon të dhënat e

matësit për qëllimet e këtij kodi të matjes ose ndonjë kodi të transmetimit dhe të shpërndarjes për këtë qëllim ose shitësit me pakicë ose shumicë;

c) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes me pëlqimin e qartë të informuar të klientit përkatës;

d) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes në masën e kërkuar nga ligji ose nga kërkesa e ligjshme e:

i. çdo institucioni shtetëror ose organi qeveritar, autoriteti ose agjencie që ka juridiksion mbi OST-në, OSSH-në dhe/ose Operatorin e Kombinuar ose një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë ose organet e tij përkatëse të korporatës;

ii. çdo burse (pronar) që ka juridiksion mbi OST-në, OSSH-në dhe/ose Operatorin e Kombinuar ose një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë ose të organeve të ndërmarrjes përkatëse; ose

iii. ERE-s;

e) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes të kërkuara, në lidhje me procedurat ligjore, arbitrazhin, përcaktimin e ekspertit ose mekanizëm tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas këtij kodi industrie ose ndonjë kodi tjetër të industrisë, ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Rregullores së gazit, ose rregullave të tregut me shumicë dhe pakicë;

f) përdorimin e zbulimit ose riprodhimi i të dhënave të matjes, i cili është i parëndësishëm në natyrë;

g) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes të kërkuara për të mbrojtur sigurinë e personelit ose pajisjeve; ose

h) zbulimin, përdorimin ose riprodhimin e të dhënave të matjes nga ose për llogari të

i) të paraqitur nga OST, OSSH ose Operatori i

j) Kombinuar në masën që kërkohet në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me aranzhimet e financimit të OST-së, OSSH-së dhe/ose Operatorit të Kombinuar ose tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë, investimet në shpërndarës e transmetuesit dhe/ose shpërndarësit ose tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë.

4.8.4 Në rastin e zbulimit sipas pikave 4.8.3 (b) dhe 4.8.3 (h), OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar ose tregtari me pakicë dhe/ose shumicë që bën zbulimin duhet të informojë zbulimin përkatës të konfidencialitetit të të dhënave



matëse dhe bëjë përpjekjet më të mira për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave të matjes.

4.9 Pronësia e të dhënave të matjes

4.9.1 Pronari i matësit është pronari i të gjitha të dhënave të matjes të prodhuara ose regjistruara nga ai matës. Çdo person tjetër që ka të drejtë të përdorë ato të dhëna matëse, sipas këtij kodi të matjes, ka të drejtën e një licence joekskluzive për të përdorur ato të dhëna matëse për qëllimet e biznesit të tij, në varësi të dispozitave të aktit rregullator.

5. PLANI I MENAXHIMIT TË MATJES SË GAZIT

5.1.1 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet, brenda gjashtë muajve pas lëshimit të licencës së tij të transmetimit ose shpërndarjes ose fillimit të këtij kodi të matjes, cilado qoftë e mëvonshme, të përgatisë dhe t'i paraqesë ERE-s, një plan të menaxhimit të matjes së gazit.

5.1.2 Plani i menaxhimit të matjes së gazit duhet të përmbledhë procedurat e OST-së, OSSH -së dhe/ose Operatorit të Kombinuar për:

- a) instalimin dhe pronësinë e instalimeve të matjes;
- b) standardet minimale për instalimet e matjes dhe mirëmbajtjen e kësaj saktësie, duke përfshirë planin e testimit dhe marrjes së mostrave të përmendura në pikën 3.4;
- c) mbledhjen e të dhënave të matjes;
- d) testimin në terren dhe mirëmbajtjen e instalimeve të matjes;
- e) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të matjes;
- f) detyrimet e të dhënave të matjes;
- g) menaxhimin dhe shkëmbimin e informacionit matës; dhe
- h) matjen dhe llogaritjen e vlerës së ngrohjes, me qëllim të faturimit.

5.1.3 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të rishikojë çdo vit dhe, nëse është e nevojshme, të azhurnojë planin për të siguruar funksionimin e tij efikas dhe të paraqesë planin e përditësuar në ERE për aprovim.

5.1.4 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të jetë në përputhje me planin e përgatitur në përputhje me pikën 5.1.1 dhe siç azhurnohet herë pas here në përputhje me pikën 5.1.3.

5.1.5 OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar nuk duhet të ndryshojë planin pa miratimin e ERE-s.

6. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI Përkufizimet

Në këtë kod të matjes:

“Testi i pranimit” nënkupton testimin dhe vendosjen e një matësi, korrektori ose një instalim matësi nga një prodhues ose instalues për të vendosur kalibrimin fillestar të matësit, korrektorit ose instalimit matës;

“Marrëveshje e hyrjes” do të thotë marrëveshja për aksesin e palës së tretë në një tubacion transmetimi ose shpërndarjeje të paraqitur nga OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar në përputhje me ligjin e gazit dhe rregulloret e gazit dhe i cili është aprovuar nga rregullatori përkatës;

“Akt” nënkupton aktet e nxjerra për gazin;

“Albgaz” do të thotë operatori i sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes;

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë;

“Leximi aktual i matësit” nënkupton mbledhjen fizike të të dhënave të matjes përmes një leximi të planifikuar të matësit ose një leximi të veçantë të matësit. Një lexim aktual i matësit mund të jetë e dhënë e matjes e cila është zëvendësuar në përputhje me pikën 4.4.1 (b), për një matës interval ose klauzolën 4.4.2 (b), për një matës bazë, por nuk përfshin të dhëna matëse të vlerësuara;

“Pala e prekur” do të thotë një palë që mund të preket nga pasaktësia e mundshme e një instalimi matës ose të dhënave të matjes nga ai instalim matës;

“Instrumente rregullatore të zbatueshme” do të thotë çdo akt ose instrument rregullator i bërë sipas një ligji, ose një instrumenti rregullator të lëshuar nga ERE, i cili zbatohet për një transmetues dhe/ose shpërndarës ose një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë;

“Matës bazë” do të thotë një matës pa regjistruar të dhënash;

“Instalim matës bazë” do të thotë një instalim matësi me matës bazë;

“Përpjekjet më të mira” do të thotë të veprosh me mirëbesim dhe të përdorësh të gjitha përpjekjet, aftësitë dhe burimet e arsyeshme;

“Korrigjues” do të thotë një pajisje e cila rregullon sasinë e pakorrigjuar të gazit nga kushtet aktuale në ato standarde për faturimin dhe qëllime të tjera;



“Klient” është një subjekt që blen me shumicë ose klienti fundor i gazit natyror, si dhe çdo subjekt tjetër i gazit natyror që blen gaz natyror;

“Klient me shumicë” është personi fizik ose juridik, i ndryshëm nga OST-ja ose OSSH-ja, i cili blen gaz natyror, me qëllim rishitjen brenda ose jashtë sistemit ku është i lidhur;

“Regjistruues i të dhënave” nënkupton një pajisje që mbledh dhe ruan të dhëna, në lidhje me sasinë, temperaturën dhe presionin e gazit dhe është në gjendje të:

a) transferojë të dhënat e regjistruara në një pajisje leximi portative; ose

b) qaset në mënyrë elektronike përmes një sistemi të mbledhjes së të dhënave;

“Defekt” do të thotë:

a) në lidhje me një instalim të ri të matjes, që nuk po plotëson standardet minimale; dhe

b) në lidhje me një instalim ekzistues të matësit, që nuk po plotëson standardet minimale të saktësisë që është projektuar për të përmbushur;

“Pikë e transmetimit dhe/ose shpërndarjes” do të thotë një pikë në sistemin e shpërndarjes në të cilën gazi tërhiqet nga sistemi i transmetimit ose shpërndarjes për transmetimin ose shpërndarjen te një klient dhe që normalisht ndodhet në:

a) hyrjen e instalimit të gazit të një klienti; ose

b) daljen e matësit;

“Pika e dorëzimit të kërkesës” ka kuptimin e dhënë në marrëveshjen standarde;

“Sistemi i transmetimit dhe/ose shpërndarjes” ka kuptimin që i është dhënë këtij termi në ligjin e gazit;

“Tubacioni i transmetimit dhe/ose shpërndarjes” ka kuptimin që i është dhënë këtij termi në ligjin e gazit;

“Transmetues” dhe/ose “Shpërndarës” do të thotë një person që mban një licencë sipas ligjit për të operuar një sistem transmetimit dhe/ose shpërndarjes;

“Leximi i vlerësuar” do të thotë një vlerësim në vend të leximit të matësit;

“Gaz” ka kuptimin që i është dhënë këtij termi në ligj;

“Udhëzim” do të thotë një udhëzues i botuar nga ERE;

“Baza e të dhënave të instalimit” do të thotë një bazë e të dhënave të kalibrimit të cilat një transmetues dhe/ose shpërndarës kërkohet të

mbajë në lidhje me instalimet e tij të matjes në përputhje me këtë kod të matjes;

“Matës intervali” do të thotë matës me një regjistruues të dhënash;

“Instalim i matjes së intervalit” do të thotë një instalim i matjes me një matës të intervalit;

“Me shkrim” do të thotë komunikimi i bërë nga letra, faksimi ose media elektronike;

“Matës” do të thotë një instrument që mat sasinë e gazit që kalon përmes tij dhe përfshin pajisjet shoqëruese të bashkangjitura në instrument për të filtruar, kontrolluar ose rregulluar rrjedhën e gazit;

“Klasa e matësve” nënkupton një grup matësish në të cilët:

a) të gjithë matësit janë bërë në të njëjtat specifikime nga i njëjti prodhues;

b) nuk ka ndryshime të rëndësishme në përbërësit ose materialet midis matësve; dhe

c) të gjithë matësit janë vulosur me të njëjtën kod të dhënash;

“Të dhëna matëse” do të thotë masa e sasisë së rrjedhës së gazit të marrë nga një instalim matës;

“Instalim i matjes” do të thotë matësi dhe pajisjet me instalimet shoqëruese, të cilat mund të ndodhin që përfshijnë korriguesit, rregullatorët, filtrat, regjistruuesit e të dhënave dhe telemetrinë në lidhje me një pikë shpërndarjeje;

“Standarde minimale” do të thotë, në lidhje me matësit e rinj, standardet minimale të referuara në DPM;

“Ligji i gazit” ka kuptimin që i është dhënë në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”;

“Tremujor” do të thotë një periudhë prej trembëdhjetë javësh (13) nominalisht, por që nuk e kalon një periudhë prej katërmëdhjetë (14) javë;

“Rregullat e tregut me shumicë dhe pakicë” do të thotë rregullat e administruara dhe të publikuara për tregun me pakicë ose shumicë;

“Tregtar me pakicë dhe/ose shumicë” do të thotë një person që mban një licencë sipas ligjit nr. 102/2015, ose një autorizim të tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë të dhënë nga ERE për shitjen dhe furnizimin e gazit;

“Lexim i planifikuar i matësit” do të thotë një lexim aktual i matësit në një cikël që barazohet me ciklin e faturimit të klientit, zakonisht mujor ose tremujor;



“Leximi special i matësit” do të thotë një lexim aktual i matësit që kryhet jashtë ciklit të zakonshëm të leximit për matësin;

“Adresa e furnizimit” do të thotë:

a) adresa për të cilën një klient blen gaz nga një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë, kur ka vetëm një pikë dorëzimi në atë adresë; ose

b) kur ka më shumë se një pikë dërgese në adresë, secila pikë e dorëzimit përmes së cilës klienti blen gaz nga i njëjti tregtar me pakicë dhe/ose shumicë;

“Telemetri” do të thotë pajisjet e komunikimit të përdorura për transmetimin e të dhënave të mbledhura nga një instalim matës në një sistem qendror të menaxhimit të të dhënave dhe zakonisht përfshijnë modem, telekom fiks (i cili mund të jetë i dedikuar ose pjesë e një rrjeti PSTN) ose marrës radio (i cili mund ose mund të mos jetë në formën e një rrjeti radiofonik të dedikuar, GSM, GPRS, CDMA, 3G, telefonisë satelitore ose ndonjë rrjeti tjetër të krahasueshëm);

“Testimi i tipit” do të thotë testimi i kryer për të vendosur aftësinë për qëllimin e një lloji të ri të instalimit të matjes;

“Kufiri i pasigurisë” do të thotë diapazoni brenda të cilit do të përsëriten rezultatet e testit kur një test përsëritet.

Interpretimi

Në këtë kod të matjes, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe:

a) titujt dhe shënimet në fund të faqes janë vetëm për lehtësi ose informacion dhe nuk ndikojnë në interpretimin e këtij kodi të matjes ose të ndonjë termi ose kushti të përcaktuar në këtë kod të matjes;

b) fjalët që importojnë njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas;

c) një shprehje që importon një person fizik përfshin çdo kompani, partneritet, besim, ndërmarrje të përbashkët, shoqatë, korporatë ose organ tjetër korporate dhe çdo agjenci qeveritare dhe anasjelltas;

d) një referencë në një klauzolë ose shtojcë është në një klauzolë ose shtojcë të këtij kodi të industrisë;

e) një referencë ndaj çdo statuti përfshin të gjitha statutet që ndryshojnë, konsolidojnë, rimbatojnë, shtrijnë ose zëvendësojnë ato dhe një referencë ndaj një statuti përfshin të gjitha

rregulloret, shpalljet, urdhëresat, aktet nënligjore dhe përcaktimet e nxjerra në bazë të këtij statuti;

f) një referencë ndaj një dokumenti ose një dispozite të një dokumenti përfshin një ndryshim ose plotësim, ose zëvendësim ose riparim të atij dokumenti ose asaj dispozite të këtij dokumenti;

g) një referencë për një person përfshin ekzekutuesit, administratorët, pasardhësit, zëvendësuesit e atij personi (duke përfshirë, pa kufizim, personat që marrin me rishtar) dhe caktimet e lejuara;

h) pjesët e tjera të fjalës dhe format gramatikore të një fjale ose fraze të përcaktuar në këtë kod të industrisë kanë një kuptim përkatës;

i) një periudhë kohe:

i. që daton nga një ditë e caktuar ose dita e një veprimi ose ngjarjeje do të llogaritet përjashtuar nga ajo ditë; dhe

ii. e cila fillon në një ditë të caktuar ose ditën e një akti ose ngjarjeje do të llogaritet duke përfshirë atë ditë.

j) një referencë për:

i. koha është një referencë në kohën standarde brenda kuptimit të Aktit të Kursimit të Ditës (*Daylight Saving Act*) 1971 (SA) dhe jo Koha e Verës brenda kuptimit të këtij akti;

ii. një ditë është një referencë për një periudhë që fillon menjëherë pas mesnatës dhe përfundon në mesnatën pasuese; dhe

iii. një muaj është një referencë për një muaj kalendarik.

k) një ngjarje, e cila kërkohet nën çdo term ose kusht të përcaktuar në këtë kod të industrisë për të ndodhur në ose nga një ditë e përcaktuar, e cila nuk është një ditë pune, mund të ndodhë në ose në ditën tjetër të punës.

7. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

7.1 “Kodi i matjes” hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCË 1 – VLERËSIMI, ZËVENDËSIMI DHE PARASHIKIMI – INSTALIMI I MATËSIT ME INTERVAL

1. Kërkesa për të vërtetuar leximet e matësve

Leximet aktuale të matësve do të kërkohen të vërtetohen në përputhje me pikën 4.4.1 (a) të këtij “Kodi të matjes”. Rregullat e vlefshmërisë që mund të zbatohen në të dhënat e matësit, nga matësit një instalimi të matjes së intervalit, janë:



a) të dhënat e matësit së konsumit për periudhën e leximit të matësve= shuma e të dhënave të matjes së intervalit për periudhën e leximit të matësit;

b) vlera e akumuluar e leximit e matësit është numerike dhe ≥ 0 ;

c) vlera e akumuluar e leximit e matësit është \geq vlera e mëparshme e lexuar e matësit të grumbulluar;

d) vlera e akumuluar e leximit të matësit kalon provën e lartë/e ulët;

e) data/koha e leximit të matësit > data/koha e leximit të matësit të mëparshëm;

f) vlera maksimale (për të siguruar që nuk krijohen kulme);

g) kontrollet e pavlefshme;

h) kapacitetin e thirrjes dhe kontrollin e pikës dhjetore; dhe

i) të dhënat e matësit janë në përputhje me llojin e saktë të matësve për atë pikë të dorëzimit.

2. Kërkesa për të prodhuar të dhëna matëse të zëvendësuara

Në përputhje me pikën 4.4.1 (b) të këtij kodi të industrisë, të dhënat e matësit për një instalim të matjes së intervalit do të kërkohet të zëvendësohen kur:

a) leximi aktual i matësit dështon në testet e vërtetimit;

b) ka një dështim të instalimit të matësit; ose

c) një inspektim ose testim në instalimin e matësit përcakton se ekziston një gabim i matjes.

3. Kërkesa për të prodhuar të dhëna të parashikuara të matjes

Në përputhje me klauzolën 4.5 të këtij kodi të industrisë, të dhënat e matësit për një instalim të matjes së intervalit do të kërkohet të vlerësohen kur të dhënat e matësit nuk mund të merren në afatin e kërkuar për zgjidhjen e tregut.

4. Detyrimet e transmetuesit ose shpërndarësit

a) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë llojet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 ose 8 teknika, në përputhje me klauzolën 5 të këtij programi 1, kur kërkohet që të dhënat e matësit të zëvendësohen;

b) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë teknikat e llojeve 1, 2, ose 3, në përputhje me pikën 5 të këtij programi 1, kur kërkohet të vlerësohen të dhënat e matësit;

c) transmetuesi ose shpërndarësi mund të përdorë tipin 2, përveç kur leximi i parë aktual i matësit nuk është ndërmarrë;

d) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë tipin 3, përveç kur:

i. leximi i parë aktual i matësit nuk është ndërmarrë; ose

ii. frekuenca e planifikuar e leximit të matësit është më pak e shpeshtë sesa ajo mujore dhe të dhënat nga periudha e njëjtë, ose e ngjashme, e leximit të matësit në vitin paraprak janë në dispozicion;

e) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë llojet 4, 5, 6 dhe 7 në rrethanat e përshkruara në pikat 5.4, 5.5, 5.6 dhe 5.7 të këtij programi 1, përkatësisht;

f) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë tipin 7 përpara se të ndërmerret leximi i parë aktual i matësit;

g) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdorë tipin 8 kur ka një gabim në presionin e matësit dhe/ose temperaturën e gazit;

h) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të njoftojë tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë kur përdoren të dhëna matëse të zëvendësuara ose të vlerësuara;

i) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të sigurojë që për të gjitha llojet, përveç tipit 5, të dhënat e matësit, të zëvendësuara ose të vlerësuara, të bazohen në një lexim aktual të matësit, dhe të mos bazohet në të dhëna matëse që janë vlerësuar ose zëvendësuar më parë.

5. Tipat e zëvendësimit dhe parashikimit

Teknikat për zëvendësimin dhe parashikimin e të dhënave të matjes për instalimet e matjes së intervalit janë parashikuar në këtë klauzole.

5.1 Tipi 1

Kur ka një instalim tjetër të matjes së intervalit në të njëjtën pikë matjeje për të njëjtën periudhë të të dhënave intervale me atë që zëvendësohet, OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të zëvendësojë ose vlerësojë të dhënat e matësit duke përdorur të dhëna matëse nga ai instalim i matjes së intervalit.

5.2 Tipi 2

Transmetuesi ose shpërndarësi mund të zëvendësojë ose të vlerësojë të dhënat e matësit duke përdorur të dhënat nga “Dita e Ekuivalentit më të Afërt” ose “Ashtu si Dita” nga e njëjta



periudhë e leximit të matësit në vitin e kaluar. “Dita e Ekuivalentit më të Afërt” ose “Ashtu si Dita” përcaktohet nga tabela më poshtë.

Dita	“Nearest Equivalent Day” or “Like Day” (in order of availability)
E hënë	E hënë ♦♦ E hënë♦
E martë	E mërkurë ♦♦ E martë ♦ E mërkurë ♦ E mërkurë ♦♦ E martë ♦♦
E mërkurë	E enjte ♦♦ E mërkurë ♦ E enjte ♦ E martë♦ E enjte ♦♦ E mërkurë ♦♦
E enjte	E martë ♦♦E enjte ♦ E mërkurë ♦ E martë ♦E martë ♦♦ E premte ♦
E premte	E shtunë ♦♦ E shtunë ♦
E shtunë	E diel ♦♦ E diel ♦
E diel	

Zëvendësimi ose vlerësimet për ‘Ashtu si Dita’ të jenë të detajuara më sipër, përveç nëse:

- Asnjë lexim nuk është i disponueshëm në ditën e parë të listuar, atëherë do të përdoret dita tjetër e preferuar e listuar.

? Dita ishte një festë publike, me atë rast do të përdoret e diela më e fundit.

? Dita nuk ishte një festë zyrtare dhe ‘Si Dita’ është një festë zyrtare, në këtë rast ‘*Si Day*’ që do të përdoret duhet të jetë dita më e fundit që nuk është festë zyrtare, e Shtunë ose e Diel.

- ♦♦ Ndodh në të njëjtën javë me ditën në vitin e kaluar.
- ♦ Ndodh në javën paraardhëse në atë në të cilën dita e zëvendësimit ndodh në vitin e kaluar.

5.3 Tipi 3

OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të zëvendësojë ose vlerësojë të dhënat e matësit duke përdorur të dhënat nga “Dita më e Afërt Ekuivalente” ose “Si Dita” nga leximet e mëparshme të matësve. “Dita e Ekuivalentit më të Afërt” ose “Si Dita” përcaktohet nga tabela më poshtë.

Day	“Nearest Equivalent Day” or “Like Day” (in order of availability)
E Hënë	E Hënë ♦♦
E Martë	E Mërkurë ♦♦ E Enjte♦
E Mërkurë	E Mërkurë ♦♦ E Martë ♦E Enjte ♦♦ E Martë ♦♦♦
E enjte	E Enjte ♦♦ E Mërkurë ♦ E Martë ♦ E Mërkurë ♦♦ E Martë ♦♦
E Premte	E Premte ♦♦
E Shtunë	E Shtunë ♦♦
E Diel	E Diel ♦♦

Zëvendësimet ose vlerësimet për ‘*Like Day*’ të jenë si më sipër të detajuara, përveç nëse:

- Asnjë lexim nuk është i disponueshëm në ditën e parë të listuar, atëherë do të përdoret dita tjetër e preferuar e listuar.
 - Dita ishte një festë publike, në rastin kur do të përdoret e diela më e fundit.
 - Dita nuk ishte një festë publike, por dita e preferuar është një festë zyrtare, në rastin e ‘*Like Day*’ që do të përdoret duhet të jetë dita e preferuar më e fundit që nuk është festë zyrtare.
- ♦♦ Ndodh në javën që paraprin atë në të cilën ndodh dita e vlerësimit.
 - ♦ Ndodh në të njëjtën javë si dita e vlerësimit.



5.4 Tipi 4

Të dhënat e matësit të zëvendësuar, të përdorura më parë, mund të ndryshohen para leximit aktual të matësit, ku tregtari ka rënë dakord, në bazë të informacionit specifik të faqes ose të klientit, që të dhënat origjinale të matjes, të zëvendësuara, janë në gabim dhe kërkohet një korigjim.

5.5 Tipi 5

Të dhënat e matësit, të zëvendësuara, mund të krijohen duke përdorur ndërlihdjen e thjeshtë lineare kur tregtari me pakicë ka rënë dakord.

5.6 Tipi 6

a) tregtari me pakicë dhe/ose shumicë mund të pranojë të përdorë një metodë tjetër të zëvendësimit (e cila mund të jetë një modifikim i një lloji ekzistues) kur asnjë nga llojet ekzistuese nuk është i zbatueshëm;

b) specifikat e këtij lloji mund të përfshijnë një metodë të zbatuar globalisht ose një metodë specifike sipas vendndodhjes.

5.7 Tipi 7

Para leximit të parë aktual të matësit, të dhënat e matësit mund të zëvendësohen duke përdorur një metodë të rënë dakord midis tregtarit me pakicë dhe/ose shumicë dhe OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar OST, OSSH dhe/ose Operatori i Kombinuar.

5.8 Tipi 8

Kur gabimi i matjes ka lindur nga gabimet në temperaturën e gazit dhe/ose presionin e gazit, të dhënat e matësit mund të zëvendësohen duke përdorur leximin e matësit dhe vlerësimet për temperaturën e gazit dhe/ose presionin e matësit.

SHTOJCË 2 – VLERËSIMI, ZËVENDËSIMI DHE PARASHIKIMI – INSTALIMI I MATËSIT BAZIK

1. Kriteret për të vlerësuar leximet e matësve

Lexime aktuale të matësve do të kërkohet të vlerësohet në përputhje me klauzolën 4.4.2 (a) të këtij kodi të industrisë. Rregullat e vlefshmërisë që mund të zbatohen në të dhënat e matësit nga matësi i një instalimi bazë të matjes janë:

a) vlera e leximit të matësit është numerike dhe ≥ 0 ;

b) vlera e leximit të matësit është \geq vlera e leximit të matësit të mëparshëm;

c) vlera e leximit të matësit kalon testin e lartë/e ulët;

d) data e leximit të matësit $>$ data e leximit të matësit të mëparshëm;

e) kontrollat e pavlefshme;

f) kontrolli i kapacitetit të thirrjes dhe pikës dhjetore; dhe

g) të dhënat e matësit janë në përputhje me llojin e saktë të matësit për atë pikë transmetuesi dhe/ose shpërndarjeje.

2. Kriteret për të prodhuar të dhëna matëse të zëvendësueshme

Në përputhje me pikën 4.4.2 (b) të këtij kodi të matjes, të dhënat e matësit për një instalim bazë të matjes do të kërkohet të zëvendësohen kur:

a) leximi aktual i matjes dështon në testet e vlerësimit;

b) ka një dështim të instalimit të matjes;

c) një inspektim ose provë në instalimin e matjes përcakton se ekziston një gabim i matjes; ose

d) një lexim i vlerësuar lejohet sipas Transfertës së Energjisë së Klientit dhe Kodit të Miratimit dhe kërkohet të transferojë një klient të një tregtar me pakicë dhe/ose shumicë i ri.

3. Kriteret për të prodhuar të dhëna të vlerësuara të matjes

Në përputhje me klauzolën 4.5 të këtij kodi të matjes, të dhënat e matësit për një instalim bazë të matjes do të kërkohet të vlerësohen aty ku të dhënat e matësit nuk mund të merren në afatin e kërkuar për zgjidhjen e tregut.

4. Detyrimet e shpërndarësit

a) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdori tipat 1, 2, 3, 4, 5 ose 6, teknikat në përputhje me pikën 5 të këtij programi 2, kur kërkohet që të dhënat e matësit të zëvendësohen;

b) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdori tipat 1, 2 ose 3, teknikat në përputhje me pikën 5 të këtij programi 2, kur kërkohet që të dhënat e matësit të vlerësohen;

c) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të përdori tipin 6 kur ka një gabim në presionin e matësit dhe/ose temperaturën e gazit;

d) OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar duhet të njoftojë tregtarin me pakicë dhe/ose shumicë kur përdoren të dhënat e matjes të zëvendësuara ose të vlerësuara:



i. transmetuesi dhe/ose shpërndarësi duhet të sigurojë që për të gjitha tipat, të dhënat e matësit të zëvendësuara ose të vlerësuara bazohen në një lexim aktual të matësit dhe nuk bazohet në të dhëna matëse që janë zëvendësuar ose vlerësuar më parë.

5. Tipat e zëvendësimit dhe të vlerësimit

Teknikat për zëvendësimin dhe vlerësimin e të dhënave të matjes për instalimet bazike të matjes janë parashikuar në këtë klauzolë.

5.1 Tipi 1

Zëvendësimi ose vlerësimi = Konsumi mesatar ditore nga periudha e leximit të matësit të vitit të kaluar, e njëjtë, ose të ngjashëm

* Numri i ditëve të kërkuara për t'u zëvendësuar ose vlerësuar.

5.2 Tipi 2

Zëvendësimi ose vlerësimi = Konsumi mesatar ditore nga periudha e leximit të matësit paraardhës

* Numri i ditëve të kërkuara për t'u zëvendësuar ose vlerësuar.

Shënim: Kur frekuenca e leximit të matësit të planifikuar është më pak e shpeshtë se mujore, tipi 2 duhet të përdoret vetëm kur konsumi nga periudha e leximit të matësit të njëjtë, ose të ngjashëm, i vitit të kaluar nuk është i disponueshëm.

5.3 Tipi 3

Zëvendësimi ose vlerësimi = Konsumi mesatar ditore për të njëjtën klasë konsumatori me të njëjtin lloj përdorimi

* Numri i ditëve të kërkuara për t'u zëvendësuar ose vlerësuar

Shënim: Tipi 3 do të përdoret vetëm kur konsumi nga periudha e leximit të njëjtë, ose të ngjashëm, i vitit të kaluar dhe konsumi nga periudha e leximit të matësit nga periudha e leximit të matësit të mëparshëm nuk janë të disponueshme.

5.4 Tipi 4

a) Tregtari me pakicë dhe/ose shumicë dhe OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar mund të bien dakord të përdorin një metodë tjetër të zëvendësimit (e cila mund të jetë një modifikim i një tipi ekzistues) ku asnjë nga tipat ekzistues nuk është i zbatueshëm.

c) Specifikat e këtij tipi mund të përfshijnë një metodë të zbatuar globalisht ose një metodë specifike në varësi të vendndodhjes.

5.5 Tipi 5

Të dhënat e matësit, të zëvendësuara, të përdorura më parë, mund të ndryshohen, para leximit të matësit aktual, kur tregtari me pakicë dhe/ose shumicë dhe OST-ja, OSSH-ja dhe/ose Operatori i Kombinuar kanë rënë dakord, në bazë të informacionit specifik për vendin ose klientin, se të dhënat origjinale të matjes së zëvendësuar janë në gabim dhe kërkohet një korigjim.

5.6 Tipi 6

Kur gabimi i matjes ka lindur nga gabimet e bëra në matjen e temperaturës së gazit dhe/ose presionit të matësit, të dhënat e matësit mund të zëvendësohen duke përdorur leximin e matësit dhe vlerësimet për temperaturën e gazit dhe/ose presionin e matësit.

VENDIM

Nr. 270, datë 28.12.2020

MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 94, DATË 8.6.2020 “MBI ÇMIMIN E APLIKUESHËM PËR PRODHUESIT EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2020, NË ZBATIM TË NDRYSHIMEVE TË MIRATUARA ME VKM-në NR. 396, DATË 13.5.2020”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 687, datë 22.11.2017 “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i rishikuar me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”; nenit 15; nenit 21; nenit 22, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/13 prot., datë



24.12.2020 të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, lidhur me “Çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020”,

Konstatohet se:

- ERE në bazë të nenit 10, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, i rishikuar me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”.

- Formula për llogaritjen e këtij çmimi, sipas metodologjisë së miratuar me vendimin e rishikuar të Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, të lartpërmendur, është “Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kWh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) i vitit përkatës të Bursës Hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.2 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit”.

- Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit të Bursës Hungareze të Energjisë (<https://hupx.hu/en/market-data/dam/regular-reports>), është marrë çmimi i deritanishëm mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2020, i cili rezultoi në vlerën 37.30 Euro/MWh.

- Sipas “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, me normë mesatare të shkëmbimit të vitit të fundit, kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2020. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, rezultoi se kursi mesatar i këmbimit për

11 muajt, tashmë të mbyllur të vitit 2020 (janar–nëntor), rezultoi të jetë 123.79 lekë/euro.

- Nga të dhënat paraprake rezultoi se çmimi vjetor i blerjes do të jetë 5.5403 lekë/kWh.

- Kufijtë minimalë dhe maksimalë të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi, përcaktohen sipas germave “ç” dhe “d”, të pikës 2, të VKM-së nr. 687, datë 22.11.2017, ku kufiri minimal është çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim dysHEME) dhe ai maksimal është 15% më i lartë se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 për këta prodhues (çmim tavan).

- Në rast se çmimi i blerjes do të rezultojë sipas të dhënave paraprake, për vitin 2021, ky çmim do të jetë sipas kufirit minimal (dysHEME), pra, ai i vendosur nga ERE për vitin 2016 prej 7.448 lekësh/kWh.

- ERE, sipas metodologjisë së sipërcituar, për sa kohë nuk është mbyllur viti ushtrimor 2020, nuk ka mundësinë e axhustimit/korrigjimit të komponentëve të formulës së paraqitur më sipër.

- Me vendimin nr. 7, datë 16.1.2020, Bordi i ERE-s ka miratuar çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2020, i cili bazuar në metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, të miratuar me VKM-në nr. 687, datë 22.11.2017, ka rezultuar të jetë 8.0532 lekë/kWh

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 8.6.2020, është vendosur që Çmimi i aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi, të jetë 7.448 lekë/kWh, bazuar në ndryshimet e miratuara nga Këshilli i Ministrave me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020 “Për disa ndryshime në vendimin nr.687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”.

- Duke qenë se, raporti vjetor i Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX) dhe i Bankës së Shqipërisë, publikohet në fillimin e vitit pasardhës, është e nevojshme, lënia në fuqi e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 94, datë 8.6.2020 “Mbi çmimin e aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2020, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 94, datë 8.6.2020 “Mbi çmimin e aplikueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2020, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 396, datë 13.5.2020”, deri në miratimin e një çmimi nga ERE, mbështetur në publikimin e raportit vjetor të Bursës Hungareze të Energjisë (HUPX), si dhe publikimet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit lekë/EUR.

2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 271, datë 28.12.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA
TË RINOVUESHME NGA DIELLI, ERA
DHE NGA PJESA E
BIODEGRADUESHME E MBETJEVE TË
NGURTA QË SHFRYTËZOJNË
MBETURINAT INDUSTRIALE,
URBANE DHE RURALE PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 17.1.2018 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat

industriale, urbane dhe rurale” dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/14 prot., datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 mw dhe era me fuqi të instaluar deri në 3mw në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave.

- VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj Metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM për sa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

- VKM nr. 27, datë 17.1.2018 “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale” përcakton, ndër të tjera, se për investimet për të cilat subjektet janë pajisur me autorizimin përkatës pas datës 1 janar 2018 e në vijim, ERE do të miratojë çmimin në bazë të të dhënave të grumbulluara, për sa i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e kësaj metodologjie.

- Në themel të metodologjisë së miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017 është llogaritja e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nëpërmjet formulës llogaritëse të LCOE-së (kosto e niveluar e energjisë elektrike)si më poshtë vijon:



$$LCOE = \frac{\sum \text{e kostove gjatë jetëgjatësisë}}{\sum \text{e energjisë elektrike të prodhuar gjatë jetëgjatësisë}} = \frac{\sum_{t=1}^n \frac{I_t + M_t + F_t}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

- Ku: I_t - Shpenzimet për investime në vitin t
 M_t - Operacionet dhe Shpenzimet e Mirëmbajtjes në vitin t
 F_t - Shpenzimet e lëndës djegëse në vitin t (taksa vjetore, përdorimi i tokës, qira etj.)
 E_t - Energjia elektrike e gjeneruar në vitin t
 r - Norma e interesit të kostos së impiantit
 n - Jetëgjatësia ekonomike e njësisë gjeneruese

- Ndërkohë, metodologjia e miratuar me VKM nr. 27, datë 17.1.2018 përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit që duhet të paguhet për një njësi output si pagesë për fuqinë e prodhuar, me qëllim që të arrihet një rikthim financiar i caktuar – ose të vendoset thjesht çmimi që projekti duhet të fitojë për mwh, me qëllim që të arrihet *break-even* ose të ardhurat të barazojnë kostot e prodhimit.

$$LCOE = \frac{\sum_{t=0}^n \frac{C_{I,t} + C_{L,djeg,t} + C_{O\&M,t}}{(1+r)^t}}{\sum_{t=0}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

- ERE në mbështetje të përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe akteve nënligjore në fuqi, nisur nga eksperiencia e deritanishme për miratimin e çmimeve të prodhuesve me përparësi mbështetur në legjislacionin sipërcituar, me anë të shkresës nr. __, datë __.12.2020, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka kërkuar informacion lidhur me subjektet për të cilat kjo e fundit ka lëshuar: 1. autorizimin paraprak, 2. miratimin përfundimtar për ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të vogla të rinovueshme nga dielli dhe era; si dhe gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

- Informacioni i kërkuar me anë të shkresës sipërcituar, do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era

dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020.

2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 272, datë 28.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR LLOGARITJEN E DETYRIMIT TË ENERJISË SË RINOVUESHME DHE PROCEDURËN PËR KOMPENSIMIN E PRODHUESVE ME PËRPARËSI TË ENERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa “b”, dhe 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 11, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; dhe neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/15 prot., datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve,

konstatoi se:

- ERE, në bazë të detyrimeve që rrjedhin prej ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, përcaktohet si autoriteti përgjegjës për miratimin e rregullores për detyrimin për energjinë e rinovueshme që do të paguhet nga ana e klientëve fundorë të energjisë elektrike në një bazë vjetore dhe metodologjinë për përcaktimin e këtij detyrimi, si dhe procedurën e kompensimit të diferencës për prodhuesit.

- Draftmetodologjia e hartuar “Mbi metodologjinë për llogaritjen e detyrimit të



energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike” ka si qëllim përcaktimin e llogaritjes së detyrimit të energjisë së rinovueshme që u ngarkohet të gjithë klientëve fundorë nga furnizuesit e energjisë elektrike, si dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi nga Operatori i Energjisë së Rinovueshme për nxitjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

- Draftmetodologjia përcakton, gjithashtu, llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme, ku përcaktohet se ERE do të llogarisë vlerën e detyrimit të energjisë së rinovueshme në lekë/kwh, të ngarkuar për të gjithë klientët fundorë, në përputhje me sasinë përkatëse të energjisë elektrike të matur dhe furnizuar nga furnizuesit të këta klientë fundorë.

Formula llogaritëse për përcaktimin e këtij detyrimi do të jetë:

*Detyrimi i BRE-së [lek/kwh] = (Prodhimi total i energjisë elektrike nga BRE-ja * bonus [lek/kwh]) / (parashikimi i përgjithshëm i kërkesës së brendshme për energji elektrike [kwh])*

- Sa u përket rregullimeve të detyrimit të energjisë së rinovueshme, draftmetodologjia përcakton, se çdo vit ERE do të llogarisë diferencat midis vlerave dhe shumave të parashikuara dhe atyre të arritura për nxitjen e energjisë nga burimet e rinovueshme gjatë vitit të kaluar kalendarik, si dhe rezultatet do të publikohen për të gjitha palët e interesuara dhe do të përfshihen në rishikimin e detyrimit të energjisë së rinovueshme në periudhën e ardhshme rregullatore.

- Lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve, draftmetodologjia përcakton rolin e ERE-s si autoritet përgjegjës për zgjidhjen e tyre, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 114, datë 8.7.2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e draftmetodologjisë për llogaritjen e detyrimit të

energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 273, datë 28.12.2020

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR BURIMET DYTËSORE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 70, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 15 dhe nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/16 prot., datë 24.12.2020 të hartuar nga drejtoritë teknike në lidhje me draftin e “Rregullores për burimet dytësore të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 184, datë 20.11.2019, ka filluar procedurat për miratimin e Rregullores për Burimet Dytësore të Energjisë Elektrike.

- ERE, me shkresën nr. 32/52 prot., datë 25.11.2019, ka publikuar për 3 ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të bordit, duke filluar nga data 22.11.2019. Me anë të këtij njoftimi u ftuan të gjithë palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve punë.

- Me shkresën nr. 791 prot., datë 5.12.2019, ERE ka dërguar “Rregulloren për Burimet Dytësore të Energjisë Elektrike”, për marrje mendimi pranë subjekteve: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Operatori i



Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.), Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit.

- Me shkresën nr. 10365/1 prot., datë 24.12.2019, MIE është shprehur parimisht dakord mbi vendimin e ERE-s nr. 184/2019.

- Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit është shprehur se ERE duhet të jetë diktuese ndaj OSHEE sh.a. në mënyrë që Rregullorja për Burimet Dytësore të Energjisë të mos cenojë të drejtën e konsumatorit për furnizim të pandërprerë me energji elektrike dhe të drejtën e tij për mundësinë e zgjedhjes së burimit të furnizimit me energji elektrike, duke krijuar kushtet për burime alternative furnizimi.

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), me shkresën nr. 678 prot., datë 4.2.2020, ka dërguar në ERE plotësimin e informacionit të kërkuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 184, datë 20.11.2019.

- Rregullorja është e shoqëruar nga 3 Shtojca të cilat përcaktojnë Standardet e Përgjithshme Elektrike, Cilësinë e Energjisë Elektrike, Tarifat e Aplikueshme dhe deklaratat e konformitetit të impiantit të burimit dytësor.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores për Burimet Dytësore të Energjisë Elektrike.

2. Shoqëria OSSH sh.a. brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje të bëjë vlerësimet përkatëse për kostot lidhur me instalimin e burimeve dytësore.

3. Shoqëria OSSH sh.a., brenda datës 30.4.2021, të depozitojë në ERE për shqyrtim, vlerësimet për kostot lidhur me instalimin e burimeve dytësore.

4. Nëse kostot e vlerësuara nga OSSH sh.a. do të rezultojnë në tarifa të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë vendim, ERE do të kryejë rishikimin e tyre në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

5. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet

ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLORE

PËR BURIMET DYTËSORE TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Miraturar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. XXX, datë XX.XX.2020

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet dhe miratohet në përputhje me dispozitat e nenit 70, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Neni 2

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton procedurat dhe kushtet teknike për instalimin nga klientët fundorë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes të një burimi dytësor të furnizimit me energji elektrike për të mundësuar furnizimin me energji elektrike në rastet kur ndërpritet furnizimi kryesor nga rrjeti i shpërndarjes.

Neni 3

Subjektet

Kjo rregullore zbatohet për çdo klient fundor që dëshiron të instalojë një burim dytësor të energjie rezervë dhe që është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes pavarësisht nivelit të tensionit dhe statusit të tij.

Neni 4

Përcaktimet

1. Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore, të cilët janë përcaktuar në ligjin nr. 43/2015 “Për



sektorin energjisë elektrike”, i ndryshuar, do të kenë kuptimin e përcaktuar në ligj.

2. Termat e përdorur në këtë rregullore, të përcaktuar në ligjin nr. 43/4015, kanë kuptimin e mëposhtëm:

- **Aplikim** – do të quhet paraqitja e kërkesës dhe e dokumentacionit pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, që paraqitet nga një klient për instalimin e një burimi dytësor.

- **Burim dytësor** – është një burim rezervë për prodhimin e energjisë elektrike pjesë e instalimeve të brendshme të klientit i palidhur me rrjetin elektrik të shpërndarjes dhe që ndalohe të punojë në paralel me të.

- **Çelës ngarkese kryesor** – është pajisja elektrike që është në gjendje të kyçë dhe ndërpresë (shkyçë) objektin e klientit, përkatësisht në kushtet e qarkut normal dhe, kur specifikohet, në kushtet e dhëna të mbingarkesës, defekteve në lidhje të shkurtër, mungesës së tensionit në rrjetin shpërndarës, dëmtimit të izolacionit në rrjet apo në impiant.

- **Çelësi i transferimit të ngarkesës** – është çelësi që kryen transferimin e ngarkesës nga një burim tek tjetri, respektivisht nga burimi kryesor rrjeti i shpërndarjes në burimin dytësor të instaluar nga klienti, i cili mund të jetë manual, automatik ose i kombinuar, që realizon skema manovrimi të ndryshme, në kushtet e operimit pa tension.

- **Frekuenca** – është numri i cikleve alternativ të rrymës për sekondë në të cilën funksionon sistemi elektroenergetik (matet me Hz).

- **Fuqia aktive (P)** – është vlera mesatare e marrë, për një periudhë periodike, e produktit të menjëhershëm të rrymës dhe tensionit e shprehur në W.

- **Fuqia e plotë (S)** – është produkti i tensionit r.m.s. dhe rrymës r.m.s. në elementin ose qarkun e shprehur në VA.

- **Leje** – është një leje apo autorizim e lëshuar nga autoritetet përgjegjëse me qëllim instalimin dhe ndërtimin e një burimi dytësor rezervë.

- **Mbrojtja** – është sistemi i masave për parandalimin e kushteve jonormale gjatë punës së burimit dytësor rezervë.

- **Mbrojtja në pikën e instalimit të burimit dytësor** – është mbrojtja elektrike e nevojshme për të siguruar që objekti i klientit të shkyçet për çdo ngjarje që mund të dëmtojë integritetin ose të

dëmtojë sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit elektrik shpërndarës.

- **Ngarkesë** – është një ose më shumë pajisje elektrike ose klient që marrin fuqi elektrike nga sistemi elektroenergetik. Ngarkesa është e ndryshme nga Kërkesa për energji elektrike, e cila është sasia e matur e fuqisë që kërkon ose merr ngarkesa në KW, MW ose KVA, MVA.

- **Pika e instalimit të burimit dytësor** – është vendi me koordinatat gjeografike, përfshirë adresën dhe vendndodhjen e saj në një objekt ose jashtë tij, në të cilin është instaluar burimi dytësor.

- **Procesi i instalimit** – është procedura teknike që ndiqet për të mundësuar instalimin e burimit dytësor rezervë të energjisë elektrike.

- **Testet** – janë teste që kryen nga OSSH-ja, që përfshijnë kushtet e simulimit ose kontrollin e zbatimit të rregullave standardeve të instalimit dhe funksionimit të burimit dytësor rezervë.

- **Verifikimi** – është tërësia e të gjitha masave me anë të të cilave kontrollohet përputhshmëria e instalimit elektrik me standardin e kërkuar.

KAPITULLI II

KUSHTET DHE STANDARDET TEKNIKE TË SIGURISË

Neni 5

Kërkesat e përgjithshme të sigurisë

1. Për të garantuar operimin e sigurt dhe qëndrueshmërinë e sistemit të shpërndarjes klientët fundor që kërkojnë të instalojnë një burim dytësor të energjisë elektrike duhet të zbatojnë kërkesat e Kodit të Shpërndarjes për lidhjen, operimin dhe mirëmbajtjen e burimit dytësor.

2. Për projektimin, instalimin dhe operimin e një burimi dytësor, kërkesat minimale të domosdoshme lidhur me sigurinë e operimit të tyre, janë:

a) të gjitha shtesat, modifikimet ose ri-konfigurimet në instalimet e brendshme elektrike të klientit që nevojiten për instalimin e burimit dytësor duhet të kryhen nga një person i licencuar;

b) për çdo modifikim të pikës së instalimit të burimit dytësor duhet marrë miratimi paraprak nga OSSH-ja;

c) instalimi i burimit dytësor duhet të projektohet, instalohet, testohet, kolaudohet në përputhje me standardet teknike të aplikueshme, në



veçanti, IEC 60364, të cilat jepen në aneksin 1, të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Mbrojtjet kryesore të burimit dytësor

1. Në fazat e projektimit, instalimit dhe operimit të një burimi dytësor duhet të sigurohet mbrojtja e tij nga:

- a) punimi paralel me burimin parësor të furnizimit nga rrjeti i shpërndarjes;
- b) funksionimi jokorrekt i sinkronizimit;
- c) mbingarkesa;
- d) lidhjet e shkurtra;
- e) lidhjet me tokën;
- f) rrymat në nivele mbi ato të lejuara;
- g) ndryshimi i tensionit përtej vlerave të lejuara;
- h) ndryshimi i frekuencës përtej vlerave të lejuara;
- i) shkarkimet atmosferike dhe mbitensionet e induktuara.

2. Kërkesat themelore për projektimin e skemave të mbrojtjes janë si më poshtë:

a) sistemi i mbrojtjes do të sigurojë që çdo defekt i brendshëm në instalimin dhe operimin e burimit dytësor nuk shkakton probleme dhe pasoja të rrjeti i shpërndarjes dhe përdoruesit e tjerë të këtij rrjeti;

b) sistemi i mbrojtjes do të sigurojë që çdo defekt i rrjetit të shpërndarjes nuk shkakton efekte dëmtoese për burimin dytësor.

3. Klienti që instalon burimin dytësor, garanton dhe është përgjegjës për kontrollin dhe mirëmbajtjen e sistemit të mbrojtjes gjatë operimit të burimit dytësor.

4. Në rastet e dështimit të mbrojtjes, që mund të vijnë nga dështimi i pajisjeve mbrojtëse apo të kontrollit dhe/ose humbjes së fuqisë së kontrollit, burimi dytësor duhet të shkëputet menjëherë nga operimi.

Neni 7

Mbrojtja rele e burimit dytësor

1. Për të rritur shkallën e sigurisë gjatë operimit të një burimi dytësor, OSSH-ja mund të kërkojë nga klienti fundor që planifikon të instalojë një burim të tillë, pajisjen me mbrojtje rele kohe dhe/ose drejtimi fuqie të burimit dytësor.

2. Releja e kohës duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) koha maksimale e lejuar për punimin në paralel është 1 sekondë ose 60 cikle;

b) releja e kohës për të shmangur punimin në paralel, duhet të jetë e aftë të veprojë ndaj mbrojtjes shtesë që duhet të veprojë mbi çelësin e burimit dytësor rezervë ose të çelësit kryesor.

3. Releja e drejtimit të fuqisë duhet të instalohet në anën e klientit (në anën sekondare të transformatorit) dhe duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) releja duhet të tarohet që të jetë e aftë të veprojë në çelësin e burimit dytësor rezervë ose në çelësin kryesor.

b) releja duhet të tarohet dhe të jetë e aftë që të dedektojë rrymën e magnetizimit të transformatorit të shpërndarjes pas energjizimit.

4. Në rast se kërkohet pajisja me rele mbrojtëse, ato do të jenë pjesë e testimit dhe komisionimit nga përfaqësuesit e OSSH-së.

Neni 8

Çelësi i transferimit të ngarkesës

1. Çdo burim dytësor duhet të jetë i pajisur me çelësin elektrik të transferimit të ngarkesës nga një burim i energjisë elektrike tek tjetri.

2. Çelësi elektrik i transferimit të ngarkesës mund të jetë manual, automatik ose i kombinuar. Ai duhet të zgjidhet në përputhje me standardet më të mira evropiane dhe në funksion të:

a) ngarkesës maksimale;

b) rrymës maksimale të lidhjes së shkurtër.

Çelësi automatik i transferimit të ngarkesës (*Automatic Transfer Switch – ATS*) instalohet shpesh aty ku gjendet burimi dytësor, në mënyrë që burimi të mund të sigurojë përkohësisht energji elektrike nëse energjia elektrike nga rrjeti i shpërndarjes ndërpritet ose mungon.

3. Në varësi të llojit të klientit, ekzistojnë tri metoda përzgjedhëse që garantojnë kalimin e sigurt të ngarkesës nga një burim i energjisë elektrike tek tjetri, siç përcaktohen më poshtë:

a) *Transferim/Kontakt i Hapur/Shkëputur nëpërmjet një çelësi me dy pozicione.*

Në këto lloj çelësash ngarkesa duhet të shkëputet paraprakisht nga një burim para se të lidhet me burimin tjetër. Ky lloj çelësi gjen zbatim



për ngarkesa të karakterit induktiv të ulët dhe jo të rëndësishë së veçantë.

b) *Transferim/Kontakt i Vonuar/Programuar nëpërmjet një çelësi me dy pozicione.*

Ky lloj çelësi përdoret me ngarkesa të karakterit induktiv të tilla si ngarkesa motorike dhe transformatorët. Ngarkesa shkëputet nga një burim, pastaj ndalon për një kohë të programuar në një pozicion “të fikur” (*off*) para kontaktit/lidhjes me burimin tjetër me qëllim për t’u mbrojtur nga mbi-tensionet e krijuara gjatë procesit kalimtar.

Çelësi me kalim të vonuar gjithashtu mund të përdoret me opsionin e shkarkimit të ngarkesës për kategori klientësh jo të rëndësishë së veçantë.

c) *Transferim/Kontakti i Mbyllur/Kyçur nëpërmjet një çelësi me tri pozicione.*

Çelësat e transferimit/kalimit të mbyllur përdoren për instalimin e burimeve dytësore nga klientët/përdoruesit për të cilët ndërprerja e furnizimit me energji elektrike përbën rrezik për jetën e njerëzve dhe mund të shkaktojë dëmtimin e pajisjeve apo humbjen e të dhënave elektronike, prishjen e prodhimit për shkak të ndërprerjes së proceseve teknologjike etj.

Çelësi automatik i transferimit të ngarkesës duhet të jetë i pajisur me funksion shtesë, në rast të refuzimit të veprimeve të kontakteve për të parandaluar funksionimin paralel të burimit dytësor me rrjetin e shpërndarjes.

Kontrollet për kalimin e transferimit duhet të parandalojnë operimin paralel të burimit të klientit dhe sistemit elektrik të OSSH-së për një periudhë jo më të gjatë se një sekondë (60 cikle).

KAPITULLI III

PROCEDURAT E NJOFTIMIT/MIRATIMIT, INSTALIMIT DHE TESTIMIT TË BURIMEVE DYTËSORE REZERVË

Neni 9

Njoftimi i OSSH-së për instalimin

1. Çdo klient që dëshiron të instalojë një burim dytësor për t’u furnizuar me energji elektrike duhet të njoftojë OSSH-në të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara instalimit të burimit dytësor lidhur me synimin e tij për këtë instalim.

2. Njoftimi duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e klientit;

b) adresën dhe vendndodhjen e objektit ku do të instalohej burimi dytësor;

c) një përshkrim i detajuar i burimit dytësor;

- planimetria e vendosjes së burimit dytësor;

- dokumentacioni i konfigurimit të burimit dytësor;

- specifikimet teknike, përfshirë tipin dhe kapacitetin e burimit;

- sistemet e emergjencës;

d) një përshkrim i detajuar i sistemeve të tij të kontrollit;

e) dokumentacionin teknik të çelësit të transferimit të ngarkesës;

f) dokumentacionin teknik të pajisjes sinkronizuese;

g) skemat elektrike të instalimit dhe lidhjes së burimit dytësor;

h) identifikimin e të gjitha mbrojtjeve kryesore;

i) një përshkrim të rendit të ngjarjeve për operacionin e transferimit dhe specifikimet për çdo pajisje mbrojtëse të kërkuar nga OSSH-ja;

j) kopje të dokumentacionit origjinal teknik të lëshuar nga prodhuesi i burimit dytësor;

k) çdo informacion tjetër teknik të disponueshëm që ka lidhje me burimin dytësor;

l) data kur parashikohet të vihet në funksion burimi dytësor.

Neni 10

Mundësia e kërimit të miratimit nga OSSH-ja

1. Klienti fundor që dëshiron të instalojë një burim dytësor të energjisë elektrike mund të kërkojë nga OSSH-ja vlerësimin e projektit teknik të instalimit të burimit dytësor, përfshirë miratimin e tij nëse e gjen në përputhje me të gjitha kushtet dhe standardet teknike në fuqi.

2. Një kërkesë për miratim sipas këtij neni mund të bëhet përpara ose të kombinohet me njoftimin sipas nenit 9.

3. Kërkesa për miratim shqyrtohet nga OSSH-ja, nuk do të jetë më shumë se 20 ditë pune prej datës së paraqitjes.

Neni 11

Sigurimi i dokumentacionit të plotë

1. Në rastet kur informacioni dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për një njoftim sipas



nenit 9 ose miratimi sipas nenit 10 nuk është i plotë apo kur OSSH-ja gjykon se është i nevojshëm paraqitja e informacionit dhe/ose dokumentacionit shtesë për instalimin e një burimi dytësor, ajo mund t'i kërkojë klientit paraqitjen e informacionit dhe/ose dokumentacionit të kërkuar brenda një afati kohor të arsyeshëm, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 3, të nenit 10.

2. OSSH-ja, pas dorëzimit të informacionit dhe dokumentacionit të munguar ose shtesë nga ana e klientit fundor, shprehet mbi kërkesën e paraqitur brenda 5 (pesë) ditëve pune.

Neni 12

Lejet dhe autorizimet nga institucione përkatëse

Në çdo rast, klienti duhet të marrë lejet dhe miratimet që kërkojnë nga autoritetet përkatëse për instalimin e një burimi dytësor që mund të përfshijnë:

- leje nga autoritetet lokale;
- miratime të tjera nga organet përkatëse.

Neni 13

Instalimi i burimit dytësor

1. Klienti mund të vijojë me instalimin e burimit dytësor 30 (tridhjetë) ditë mbas dërgimit të njoftimit sipas nenit 5 ose menjëherë mbas marrjes së miratimit nga OSSH-ja sipas nenit 6.

2. Instalimi i burimit dytësor duhet të kryhet nga një person i licencuar.

Neni 14

Deklarimi i konformitetit

Pas instalimit të burimit dytësor, personi përgjegjës për instalimin, lëshon dhe nënshkruan një deklaratë të konformitetit në të cilën konfirmohet, se:

a) instalimi i burimit dytësor është bërë në mënyrë profesionale;

b) instalimi i burimit dytësor është bërë sipas projektit të paraqitur dhe miratuar nga OSSH-ja dhe çdo ndryshim nga projekti, nëse ka, nuk e përkeqëson pajtueshmërinë, performancën dhe sigurinë e rrejtës të shpërndarjes. Çdo ndryshim projektit i raportohet OSSH-së sipas deklaratës së konformitetit;

c) të gjitha materialet, komponentët dhe pajisjet e përdorura në instalimin e burimit dytësor janë përzgjedhur sipas projektit dhe përmbushin kërkesat dhe rregullat teknike në fuqi.

Neni 15

Njoftimi i instalimit

Menjëherë pas përfundimit të instalimit të burimit dytësor, klienti njofton me shkrim OSSH-në.

Neni 16

Testimi dhe komisionimi i instalimit të burimit dytësor

1. Bashkë me njoftimin për përfundimin e punimeve të instalimit sipas nenit 14, klienti i dërgon OSSH-së një plan testimi dhe komisionimi të detajuar për burimin dytësor të instaluar.

2. Testimi dhe komisionimi i instalimeve të burimit dytësor bëhet jo më vonë se 28 ditë nga njoftimi i përfundimit të punimeve të instalimit.

3. Testimet dhe komisionimi i burimit dytësor kryhen nga inxhinierë të licencuar, të certifikuar, të autorizuar nga klienti dhe gjithmonë në prani të përfaqësuesve të OSSH-së.

4. Gjatë fazës së testimit kryhen dy lloje testesh:

a) *Testet e përputhshmërisë së parametrave të burimit dytësor*

Klienti është përgjegjës për të vërtetuar që burimi dytësor dhe parametrat e tij janë përmbushin kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe të standardeve teknike në fuqi.

b) *Testet e pajtueshmërisë me rregullat dhe standartet teknike të lidhjeve elektrike të brendshme.*

Testet duhet të konfirmojnë se lidhja është bërë sipas skemës së miratuar, instalimet janë në përputhje me standartet teknike, tarimet janë vendosur sipas kufijve të parashikuar sipas standardeve teknike dhe se lidhja e burimit dytësor nuk sjell pasoja të dëmshme në funksionimin e rrejtës të shpërndarjes.

5. Për komisionimin/vënien në punë duhet të kryhen testet e mëposhtme:

a) garantimi që burimi dytësor nuk punon paralel me sistemin e shpërndarjes;

b) funksionimi i çelësit të transferimit të ngarkesës;



c) skemat e ndërlidhjes së mbrojtjeve, burim dytësor – rrjet shpërndarje (nëse ka);

d) testet funksionale të pajisjeve të përdorura;

e) matjen e parametrave të cilësisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga burimi dytësor.

6. Gjatë procesit të testimit dhe komisionimit të burimit dytësor dhe instalimeve të tij duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të shmangur ndikimet e dëmshme në funksionimin e rrjetit të shpërndarjes.

Neni 17

Lidhja me rrjetin e shpërndarjes

1. Mbas përfundimit të testeve, nëse nga ana e OSSH-së nuk ka asnjë vërejtje, klienti mund të lidhë burimin dytësor në skemën elektrike.

2. OSSH-ja dhe klienti lidhin një marrëveshje lidhje në të cilën përcaktohen standardet dhe kërkesat minimale teknike të lidhjes dhe operimit të burimit dytësor.

3. OSSH sh.a. duhet të përgatisë një kontratë standarde që do të përdoret për marrëveshje lidhje dhe operim të burimeve dytësore. Kjo marrëveshje duhet të aplikojë parime dhe njëta për të gjithë klientët fundorë dhe të garantojë trajtimin e barabartë të klientëve fundorë.

Neni 18

Instalimi i burimit dytësor në një objekt të ri

Në rast se një burim i dytësor planifikohet të instalohet në një objekt të ri, projekti i burimit dytësor do të integrohet me projektin e përgjithshëm elektrik të objektit dhe instalimi dhe testimi i tij do të kryhet në të njëjtën kohë me instalimet e tjera elektrike të objektit në përputhje me Rregullat e lidhjeve të reja.

KAPITULLI IV DISPOZITA TË TJERA

Neni 19

Lehtësimi i inspektimit

1. Klienti fundor është i detyruar të mundësojë inspektimin e burimit dytësor nga OSSH-ja në çdo kohë mbas instalimit të tij.

2. Klienti fundor i paraqet OSSH-së të gjithë dokumentacionin përkatës teknik, nëse kjo është e nevojshme dhe kërkohet për qëllim të inspektimit.

Neni 20

Instalimi i paautorizuar

OSSH-ja ka të drejtë të ndërmarrë masa deri në shkëputjen e lidhjes me rrjetin të klienti fundor në rast se klienti fundor nuk përmbush detyrimet e parashikuara në dispozitat e kësaj rregulloreje, dhe vijimi i lidhjes së tij me rrjetin cenon sigurinë e operimit të rrjetit të shpërndarjes. Për raste të tilla, OSSH-ja duhet brenda 3 ditëve të realizimit të ndërprerjeve të informojë ERE.

Neni 21

Shkelja e rregullave teknike gjatë operimit

1. Në rast se OSSH-ja gjatë një inspektimi konstaton se burimi dytësor i instaluar operohet në shkelje të rregullave teknike të operimit, ajo njofton me shkrim klientin për këtë shkelje dhe i jep kohën e nevojshme për shmangien e shkeljes.

2. Në rast se një kërkesë e tillë do të injorohet apo masat e marra nuk janë të mjaftueshme për të shmangur shkeljen ose në rast të shkeljeve të përsëritura, OSSH-ja mund të shkëpusë klientin deri kur shkelja të jetë eliminuar.

3. Në rast se shkelja kërcënon operimin normal dhe të sigurt të rrjetit apo përbën rrezik për jetën dhe pasurinë e personave të tretë, OSSH-ja mund ta shkëpusë klientin pa asnjë paralajmërim.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet me vendim të Bordit të ERE-s dhe hyn në fuqi menjëherë, sipas dispozitave të përcaktuara në këtë vendim.



SHTOJCË 1
STANDARDE TË PËRGJITHSHME ELEKTRIKE

IEC 60364-5-55	Instalimet elektrike të ndërtesave - Pjesa 5-55: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjeve elektrike - Pajisjet e tjera.
EC60364-7-715:2011	Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 7-715: Kërkesat për instalime ose vendndodhje specifike - Instalime ndriçimi me tension të ulët.
IEC 60664-1	Koordinimi i izolimit për pajisjet brenda sistemeve të tensionit të ulët - Pjesa 1: Parimet, kërkesat dhe provat.
IEC 60909-1	Rrymat e qarkut të shkurtër në tri faza a.c. të sistemeve - Pjesa 1: Faktorët për llogaritjen e rrymave të qarkut të shkurtër sipas IEC 60909-0.
IEC 60909-0:2016	Mbrojtja ndaj rrufesë - Pjesa 3: Dëmtimi fizik i strukturave dhe rreziku për jetën.
IEC 62305-3	Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 1: Parimet bazë, vlerësimi i karakteristikave të përgjithshme, përkufizimet.
IEC 60364-1	
IEC 60364-5-54	Instalime elektrike të tensionit të ulët - Pjesa 5-54: Përzgjedhja dhe ndërtimi i pajisjeve elektrike – Sistemimi i tokëzimit dhe përcjellësit mbrojtës.
IEEEC 37.90	Standardi IEEE për reletë dhe sistemet rele që lidhen me aparatet e energjisë elektrike.

Cilësia e energjisë elektrike

IEC 61000-3-2	Përputhshmëria elektromagnetike (EMC) - Pjesa 3-2: Kufijtë - Kufijtë për emetimet e rrymës harmonike (rryma e hyrjes së pajisjeve ≤16 A për fazë).
IEC 61000-3-3	Pajtueshmëria elektromagnetike (EMC) - Pjesa 3-3: Limitet - Kufizimet e ndryshimeve të tensionit, luhatjeve të tensionit dhe luhatjeve të mëdha të tensionit në sistemet publike të furnizimit me energji me tension të ulët, për pajisje me rrymë të vlerësuar ≤16 A për fazë dhe që nuk janë subjekt i lidhjes së varur.
IEC 61000-6-1	Përputhshmëria elektromagnetike (EMC) - Pjesa 6-1: Standardet gjenerike - Standardi për ambiente banimi, tregtare dhe të industrisë së lehtë.
IEC 61000-6-3	Pajtueshmëria elektromagnetike (EMC) - Pjesa 6-3: Standarde të përgjithshme - Standarde për emetimet në mjedise banimi, tregtare dhe të industrisë së lehtë.
IEEE519-1992	IEEE Rekomandoi praktikën dhe kërkesat për kontrollin e harmonizimit të sistemeve të energjisë elektrike, Instituti i Inxhinierëve Elektrik dhe Elektronik, Piscataway, NJ. prill 1992.



SHTOJCË 2 TARIFAT E APLIKUESHME

1. Klienti ekzistues, i cili kërkon të instalojë burimin dytësor

T1 është tarifë fikse, lidhur me kostot e aplikimit, kontrollin e dosjes nga ana e dokumentacionit, studimin dhe vlerësimin e dokumentacionit, për implementimin e burimit dytësor.

a) Për klientët familjarë - T1 = 1000 lekë

b) Për klientët jofamiljarë në tension të ulët - T1 = 5000 lekë

c) Për klientët e lidhur në tension të mesëm 6/10/20 kV – T1 = 23000 lekë

d) Për klientët e lidhur në 35kV = 30 000 lekë

Tarifa T2 = 0

Tarifa T3 = 0

Tarifa T4 = 1500 lekë (tarifë azhurnimi, inspektimin në terren)

2. Klienti kërkon lidhje të re ose modifikim lidhje dhe instalim të burimit dytësor

Në raste të tilla preventivat do të përgatiten dy preventiva një për lidhjen e re dhe një për instalimin e burimit të dytë.

1. Tarifa e lidhjes së re do të jete konform tarifave të miratuara në rregulloren e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, për miratimin e rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”.

2. Tarifa për implementimin e burimit të dytë.

a) Për klientët familjarë - T1 = 1000 lekë

b) Për klientët jofamiljarë në tension të ulët - T1 = 5000 lekë

c) Për klientët e lidhur në tension të mesëm 6/10/20 kV – T1 = 23000 lekë

d) Për klientët e lidhur në 35kV = 30 000 lekë

Tarifa T2 = 0

Tarifa T3 = 0

Tarifa T4 = 500 lekë (Pasi inspektimi në terren behet në të njëjtën kohë me lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes)

SHTOJCË 3 DEKLARATE KONFROMTETI E IMPIANTIT TË BURIMIT DYTËSOR

Klienti: _____

Adresa: _____

Nr. i kontratës: _____

Përshkrimi: Sistemi i ri i burimit dytësor për furnizimin me energji elektrike të objektit, ndërtesë banimi me fuqi të kërkuar 5 kW.

Kopje për: Klientin / OSSH / Protokoll

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

Aprovuar:
Z. Emër Mbiemër



Nr.

Datë _____.____._____

DEKLARATË KONFROMITETI E IMPIANTIT TË BURIMIT DYTËSOR

Unë i nënshkruari Emër Mbiemër, Titullar/Përfaqësues ligjor i shoqërisë Shoqëria sh.p.k. Operator në sektorin _____, me seli në: Adresa e subjektit _____

Zotërues i impiantit elektrik të burimit dytësor: Emërtimi i impiantit _____

Lloji i impiantit: _____

Impiant i ri: _____

Impiant ekzistues: _____

Fusha e përdorimit të impiantit të burimit dytësor: _____

Familjar: _____

Privat: _____

Objekt i rëndësisë së veçantë: _____

Impianti është instaluar në: _____

DEKLAROJ:

Nën përgjegjësinë time personale se:

- instalimi i impiantit elektrik i burimit dytësor është bërë në mënyrë profesionale, nga ekspert elektrik, i licencuar i certifikuar nga organet kompetente;

- instalimi i impiantit elektrik të burimit dytësor është bërë sipas projekti të paraqitur pranë OSSH-së;

- instalimi i impiantit elektrik të burimit dytësor nuk ndikon në performancën dhe sigurinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike të OSSH-së;

- të gjitha materialet dhe pajisjet elektrike të përdorura në instalimin e burimit dytësor janë përzgjedhur sipas projektit dhe përmbushin kërkesat dhe rregullat teknike në fuqi;

- instalimi i impiantit elektrik i burimit dytësor është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8734 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar, rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik, Standardit IEC të paraqitura në rregullore;

- instalimi i impiantit elektrik i burimit dytësor është kontrolluar nga ana e sigurisë dhe funksionalitetit sipas kërkesave ligjore në fuqi. Janë instaluar të gjitha mbrojtjet përkatëse. Rezultati i kontrollit ka qenë: _____;

- si zotërues dhe shfrytëzues i burimit dytësor të energjisë, mbaj çdo përgjegjësi në lidhje me aksidentet ndaj njerëzve apo dëmeve, të shkaktuara nga mosfunksionimi normal i burimit dytësor, ose nga mosmirëmbajtja e impiantit të burimit dytësor të energjisë.

Instalimi i impiantit elektrik i burimit dytësor me të dhënat e mëposhtme:

- Modeli:

- Fuqia kVA – kw:

- Numri serial:

- Viti i ndërtimit:

- Niveli i zhurmës:

- Lartësia maksimale:

- Temperatura maksimale:

Impianti është konform rregullave teknike në fuqi dhe është i gatshëm për t'u lidhur në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike të OSSH-së.

**Bashkëlidhur kësaj deklaratë gjeni dokumentacionin si më poshtë:**

- Projekti elektrik i impiantit të burimit dytësor, përfshi skemat elektrike të lidhjes së burimit dytësor me rrjetin e shpërndarjes së OSSH-së.
 - Planimetria e vendosjes së burimit dytësor në objekt.
 - Dokumentacioni i konfigurimit të burimit dytësor
 - Specifikimet teknike të burimit dytësor të energjisë, tipi, kapaciteti etj.
 - Sistemet e emergjencës të burimit dytësor të energjisë.
 - Relacioni teknik i sistemeve të kontrollit të burimit dytësor.
 - Dokumentacioni teknik i çelësit të transferimit të ngarkesës.
 - Dokumentacioni teknik i pajisjes sinkronizuese.
 - Verifikimi i kryer nga eksperti elektrik të licencuar i certifikuar.
 - Kopje e dokumentacionit original teknik të lëshuar nga prodhuesi i burimit dytësor.
- Certifikata që lëshohen nga institucione të tjera jashtë OSSH-së në lidhje me ndotjen akustike; ndotjen mjedisore për sa i përket ndikimit në mjedis të burimit dytësor që do të instalohet.

Deklaruesi
Emër Mbiemër

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë